



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kryetarin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) lidhur me veprimtarinë e këtij enti gjatë vitit 2021 (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Flamur Hoxha, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Mungojnë:

Rahman Rraja, Benet Beci dhe Fatjon Veizaj.

Të ftuar:

Tomi Frashëri – Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)

Eriola Mosko – Drejtoreshë Kabineti në AKEP

Gazmir Mani – Drejtor Tregu në AKEP

Bleron Dokle – Drejtor Juridik në AKEP

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rendin e ditës, sikurse jeni në dijëni, kemi një seancë dëgjimore me kryetarin e Këshillit drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, zotin Frashëri, për raportin vjetor të AKEP-it për vitin 2021. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është zoti Duraj.

Së bashku me zotin Frashëri prezent janë edhe zonja Eriola Mosko, drejtoreshë Kabineti, zoti Gazmir Mani, drejtor Tregu dhe zoti Bleron Dokle, drejtor Juridik.

Mirë se erdhët!

Po, zoti Bushati, për procedurë.

Helidon Bushati – Meqenëse sot prezantohet puna vjetore e AKEP-it, e një institucioni të rëndësishëm, mendoj se procedura duhet të jetë pyetje dhe përgjigje, sipas deputetëve njëri pas tjetrit. Pra, një nga maxhoranca dhe një nga opozita, por njëri pas tjetrit që të mos ketë bashkim të të gjitha pyetjeve. Meqenëse fusha dhe spektri i punës së AKEP-it është shumë i gjerë, ndonjëherë, kur bëhen shumë pyetje, kalojnë pa pasur vëmendjen e duhur. Kaq kisha.

Arben Pëllumbi – Në rregull!

E shikojmë dhe mund të procedojmë edhe kështu.

Zoti Frashëri, fjala është për ju, për të na bërë një përmbledhje të shkurtër, për t'u dhënë mundësi edhe deputetëve më pas, pasi deputetëve u është shpërndarë raporti juaj dhe të gjithë e kemi parë. Pra, sa më shkurt, në mënyrë që deputetët të kenë mundësi të sqarohen për ato paqartësi që mund të kenë në lidhje me aktivitetin e organit tuaj. Faleminderit!

Tomi Frashëri – Zoti kryetar,

Zonja dhe zotërinj, anëtarë të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin,

Së pari, më lejoni t'ju falënderoj për rëndësinë që i jepni Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që të paraqesë përpara jush raportin e veprimtarisë për vitin 2021.

Sikundër vërehet, raporti vjen i faqosur me një fotografi në plan të parë nga një segment i bajpasit të Vlorës, i cili pa asnjë hapjeje të pjesshme vitin e kaluar do të vendoset tërësisht në shërbim të qarkullimit të automjeteve këtë sezon veror. Bëhet fjalë, sigurisht, për një nga

realizimet infrastrukturore më madhore të shtetit shqiptar vitet e fundit, por, gjithashtu, për sa i përket AKEP-it edhe për një nga detyrimet që i takojnë institucionit si rregullator i komunikimeve elektronike për të nxitur dhe për të koordinuar në vijimësi mbulimin me rrjete të shpejtësisë së lartë nga operatorët privatë të çdo gjymtyre strategjike dhe me interes publik të territorit.

Për ecurinë e këtij procesi, si dhe në përgjithësi për vijueshmërinë e zhvillimit të qëndrueshëm në sektor, raporti i vitit 2021 sjell fakte bindëse se jemi në drejtimin e duhur dhe se për të ardhmen afatgjatë mund të jemi mjaftueshëm optimistë.

Qëndrueshmëria mjaft e madhe e rrjeteve fiks dhe *mobile* gjatë sprovës dyvjeçare të pandemisë nxiti sipërmarrësit në vend të investonin edhe më shumë në modernizimin e tyre. Nga 75%, që ishte mbulimi i territorit me rrjete 4G në vitin 2019, ai shkoi drejt kompletimit tërësor me 95,90% vitin e kaluar. Me rëndësi është të vërehen përpjesëtimet gjithmonë e më të mëdha që po merr investimi në fibrën optike për sa i përket cilësisë së ofertës *broadband* në rrjetet fikse. Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit *broadband* në rrjete fikse për vitin 2021 rezulton të jetë fibra me më shumë se 56% të totalit të lidhjeve, duke u rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2020, gjatë të cilit fibra ishte prezente vetëm në 46% të lidhjeve.

Qëndrueshmëria e rrjeteve e testuar nga nevoja e shumëfishuar për internet cilësor dhe të shpejtë gjatë pandemisë krijoi, gjithashtu, një besueshmëri në rritje ndaj medimeve digjitale të përdoruesi fundor, përditshmëria e të cilit nuk mund të konceptohet dot sot e shkëputur nga telendërveprimet. Fraktura digjitale ka ardhur për pasojë duke u tkurrur gjithmonë e më shumë edhe në Shqipëri. Vetëm gjatë vitit 2021 volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet *mobile* u rrit me pothuajse 75%, krahasuar me vitin 2020. Si rrjedhojë, konsumi mesatar mujor i internetit për pajtimtarë është rritur me rreth 64%, krahasuar me një vit më parë.

Në të njëjtën linjë me rritjen eksponenciale të volumit të përdorimit të internetit nëpërmjet rrjetit celular, edhe trafiku i internetit *broadband* nga rrjetet fikse u rrit në rreth 56% më shumë se viti 2020. Falë kësaj dinamike, pajtimtarët e pajisur me akses *broadband* fiks ishin 10% më shumë në tremujorin e katërt të vitit 2021, krahasuar me të një njëjtën periudhë të vitit pararendës.

Pjesa e pajtimtarëve që përdorin internet nga rrjeti fiks me shpejtësi më shumë se 10 mbps ka arritur në 83%, krahasuar me rreth 67% që ishte në vitin 2020. Me rëndësi të posaçme është edhe rritja e konsiderueshme e evidentuar në lidhjet me shpejtësi më të madhe se 100

mbps, ku nga rreth 15 mijë e 406 në vitin 2020, pajtimtarë në vitin 2021 ishin 55 mijë e 65, ndërkohë që numri i pajtimtarëve me lidhje *broadband* me shpejtësi 1 gbps ose më të madhe është pesëfishuar, krahasuar me vitin 2020. Faktet e mësipërme përbëjnë tregues mjaft pozitivë në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në Planin Kombëtar *Broadband* për infrastrukturë digjitale *broadband* të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, duke konsoliduar kështu themelet e një shoqërie të qëndrueshme gigabit.

Teksa Shqipëria po përparon, falë një politike të qartë zhvillimore dhe një kompleksi industrial privat telekomunikacioni mjaft robust, drejt kushteve gjithmonë e më optimale për implementimin e një ekosistemi digjital të qëndrueshëm, AKEP-i ka ndërmarrë gjatë vitit 2021 një sërë procesesh për ripërtëritjen e instrumenteve funksionale dhe rregullatore.

Prej disa vitesh tashmë, në urtësinë e tij dhe në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian, Kuvendi i Shqipërisë ka shprehur një interes legjitim përmes rezolutave të njëpasnjëshme për rishikimin e ligjit material të komunikimeve elektronike. Shtegun për këtë rishikim e ka çelur puna e nisur për transpozimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike të Bashkimit Europian. Falë koordinimit proaktiv të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, konsulentit ndërkombëtar të përzgjedhur për të asistuar në këtë proces, si dhe kontributit të AKEP-it, transpozimi i direktivës së sipërpërmendur po përfiton nga ekspertiza më e mirë në vend për t'u kryer në një mënyrë sa më të suksesshme. Sinkron me procesin e reformës legislative, AKEP-i ka ndërmarrë nga pikëpamja e funksionimit të brendshëm nisma strategjike për t'iu përshtatur realiteteve të shoqërisë digjitale. Përveç përfundimit të një modeli bashkëkohor të kostove për analizat e ardhshme të tregut, gjatë vitit 2021 u implementua një paketë e tërë sistemesh për telendërveprimet e brendshme dhe automatizimin e proceseve.

AKEP-i ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit dhe të monitorimit të cilësisë së shërbimit, mbështetur edhe në detyrat e caktuara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore në fuqi.

Kryerja me profesionalizëm e të gjitha investimeve të programuara për vitin 2021, mirëmenaxhimi i fondeve dhe zbatimi me rigorozitet i buxhetit ndikoi në uljen për të dytin vit radhazi të tepricës së derdhur në buxhetin e shtetit. Nga rreth 61 milionë lekë në vitin 2019, teprica në vitin 2021 ra në nivelet e saj më të ulëta prej disa vitesh, në rreth 34 milionë lekë. Krahas këtyre zhvillimeve, gjithmonë me synimin për të pararendur procese jetike, mes të cilave spikat marrja nën administrim dhe vënia në eficiencë e brezit 700 megahertz, AKEP-i kreu me

sukses gjatë vitit 2021 vlerësimin e parë në nivel kombëtar të kapaciteteve kombëtare për zhvillimin e rrjeteve të brezit të ri. Vlerësimi u krye në partneritet të ngushtë me shoqërinë amerikane *John's International*, e cila pak muaj më parë u bë partneri kryesor i shtetit shqiptar për implementimin e një pakete të sigurisë kibernetike në rrjetet dhe sistemet publike të informacionit.

Këshillimi publik, është e rëndësishme të thuhet, përfshiu sipërmarrësit kryesorë të komunikimeve elektronike të pajisur më autorizime individuale për shfrytëzimin e brezave relevantë të frekuencave, potencialisht të interesuar për shfrytëzimin e brezave 700 megahertz dhe 3,5 gigahertz, si dhe implementimin e teknologjive 5G.

Në aspektin e bashkëveprimeve dhe realizimeve multilaterale viti 2021 ka qenë për AKEP-in një vit i mbarë dhe ogurmirë.

Më 1 korrik të vitit 2021 u përmyll me sukses procesi i zerimit të tarifave *roaming* në të 6-ta vendet e Ballkanit Perëndimor, proces që AKEP-i vijoi dhe vijon ta monitorojë në mënyrë sistematike, në bashkëpunim me rregullatorët e rajonit dhe me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal. Përvoja frytdhënëse e këtij bashkëpunimi ka hapur tashmë rrugën e një ambicieje më të madhe, realizimi i së cilës do të integronte në mënyrë radikale, përmes ndërlidhjes digjitale, popullsitë e Ballkanit Perëndimor me ato të Bashkimit European. Është fjala këtu për zhdukjen afatgjatë të tarifave *roaming* mes Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit European, një proces që sapo ka nisur një rrugëtim të gjatë.

Së fundi, është e udhës të përmendet veprimtaria e AKEP-it në dimensionet e tij monitoruese dhe inspektuese. Lufta ndaj informalitetit në sektorin postar dhe mbrojtja e vazhdueshme e përdoruesit në sektorin e komunikimeve elektronike e kanë detyruar AKEP-in të jetë i patrajtueshëm në zbatimin e ligjit, përmes marrjes së masave administrative të qenësishme dhe proporcionale kundrejt një sërë sipërmarrësve.

Në përfundim të kësaj pasqyre shumë të përmbledhur, më vjen mirë të them se AKEP-i është i nderuar që raportin për vitin 2021 e paraqet pasi ka realizuar, falë punës së secilit punonjës, pothuajse tërësinë e rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin e kaluar, e cila është për institucionin përparësia e përparësive. Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Fjala për relatorin, zotin Duraj.

Laert Duraj – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Përshëndetje, zoti Frashëri, dhe stafit të AKEP-it!

Të gjithë ne, në përditshmërinë tonë, besoj se jemi të lidhur nga shërbimet elektronike dhe postare dhe është e qartë që jemi në një periudhë më se pozitive. Përtej shifrave dhe analizës së detajuar që u paraqit, të gjithë e dimë se heqja e tarifave *roaming*, sidomos atë që përmendi edhe zoti Frashëri, me vendet e Ballkanit Perëndimor e ka lehtësuar shumë jetën tonë. Gjithashtu, edhe çmimet e telefonisë dhe shërbimeve të internetit që ofrohen, të rrjetit 3G dhe rrjetit 4G, të cilat kanë mbuluar pothuajse mbi 95% të territorit, janë një realitet, i cili nga të gjithë ne jetohet dhe përdoret në mënyrë maksimale. Nuk dua të ndalem në shumë detaje, por, duke u nisur edhe nga përvoja ime në Postën Shqiptare, institucioni kryesor ndoshta, i cili ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me AKEP-in, unë e vlerësoj jashtëzakonisht pozitive punën e AKEP-it. Ne kemi pasur një debat shumë të madh profesional me AKEP-in në lidhje me heqjen e tarifës së dorëzimit të objekteve postare dhe kolipostës, megjithatë në fund ajo mbron edhe pozicionin e saj, por pozicioni i AKEP-it, i cili është edhe rregullator, ka qenë, le të themi, i qëndrueshëm, stoik dhe që prej 1 janarit të vitit 2021 Posta Shqiptare e hoqi këtë tarifë për këtë lloj shërbimi.

Gjithashtu, edhe në lidhje me tregun e operatorëve postarë, AKEP-i nuk ka qenë i ngurtë në njëfarë mënyre. Pra, licencimet e shërbimeve dhe kompanive postare kanë qenë të tilla që tregu ka qenë totalisht i liberalizuar dhe, sigurisht, në këtë këndvështrim, unë e vlerësoj edhe punën e AKEP-it për monitorimin e tyre. Pra, nëse nga njëra anë AKEP-i ka qenë *willing*, pra i predispozuar që të mos krijojë asnjë pengesë burokratike në ofrimin e shërbimeve postare alternative; nga ana tjetër, ka qenë në monitorim të vazhdueshëm që ky shërbim të jetë nën kontroll, të mos jetë abuzues dhe të mos cenojë ligjet e konkurrencës, kushtet e saj e të gjitha me radhë. Kështu që unë e vlerësoj dhe, gjithashtu, përfitoj nga rasti për të thënë që, duke qenë se *e-Commerce* në vetvete do të jetë një nga shërbimet kryesore të së ardhmes, pra kombinimi postar i definanciarit, ndoshta nga AKEP-i mund të ishte një pikë strategjike për vitin 2021. Ndoshta kësaj pike do t'i kushtohet një rëndësi edhe më e madhe dhe, duke qenë se jemi edhe në hapat e parë të zhvillimit të këtij tregu, rregullatori mund të ishte më ndihmues në përcaktimin e rregullave të arta dhe kushteve që duhet të plotësojë çdolloj kompanie që do të ofronte në këtë fushë, me qëllim që të shmangej edhe informaliteti, pasi në përgjithësi, sa më pak të monitoruara të jenë këto kompani edhe nga ana fiskale, shërbimet dhe mallrat që ata transportojnë dhe tregtojnë ndoshta janë më të predispozuara t'i shmangin detyrimet fiskale e kështu me radhë. Në

përgjithësi unë, si relator, e vlerësoj jashtëzakonisht pozitive performancën e AKEP-it për vitin 2021. Pikat dhe strategjitë që AKEP-i i ka vënë vetes si detyrë për vitin 2022 më duken më se të realizueshme dhe objektive për sa i përket mundësisë për t'u realizuar. Kështu që ftoj kolegët, pa diskutim, të japin një vlerësim pozitiv për punën e tij dhe për strategjinë e vitit 2022.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Në fakt, edhe në analizën që ka bërë Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, por edhe nga ajo që shikojmë në raport, pjesa më e madhe e rekomandimeve rezultojnë të realizuara. Megjithatë, zoti Frashëri, unë personalisht e kam një vërejtje në lidhje me kohën e dorëzimit të raportit. Unë ju kam kërkuar që ta sillnit raportin përpara afatit, ndërsa ju e keni sjellë pas afatit. Kështu që më duhet ta them këtë gjë dhe duhet të keni parasysh për vitin që vjen, që nuk do t'i tolerojmë dorëzimet raportit jashtë afateve zyrtare të përcaktuara nga Rregullorja e Kuvendit. A dëshiron kush ta marrë fjalën?

Atëherë, në varësi të pyetjeve, do të shikojmë edhe mundësinë që ju të përgjigjeni direkt sapo të bëhen pyetjet.

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Unë do të bëj grupin tim të pyetjeve dhe pastaj, pa dyshim, pres edhe përgjigje. Do ta filloj nga kopertina e raportit që tregon bajpasin, që u mor këtu si shembull, për sa i përket mbulimit me shërbim, konektivitetet të disa akseve dhe është një arritje shumë madhe për AKEP-in, që keni arritur të mbuloni segmentin Kuç-Gusmarë-Tepelenë. Problemi është këtu: gjatë pandemisë doli qartë hendeku digjital që ka në Shqipëri sot ndërmjet zonave rurale dhe zonave urbane, aty ku operatorët nuk kanë shumë interes për të investuar pasi, pa dyshim, kostoja dhe eficientia, rikthimi i investimit është shumë i ulët, por kjo nuk do të thotë që operatorët nuk duhet t'i mbulojnë këto zona, sepse këto zona janë të populluara mbase me pak popullsi, por janë të populluara, aq më tepër që këto zona turistike ju i keni cekur pak në raportin tuaj, si Butrinti apo zona të tjera turistike. Problemi është që vjet AKEP-i mori një angazhim për rishikimin e planit kombëtar të broadband-it në parlamentin shqiptar, plani 2020-2025 në funksion të problematikave, që dolën nga pandemia, ku kishte problem për zhvillimin e mësimin. Kjo ishte ajo që dilte qartë në medie për publikun.

E para, ju morët angazhim që brenda vitit 2021 të rregullonit planin kombëtar të “Broadband-it” me detyrat dhe kostot financiare. Pse nuk është bërë?

E dyta, arritjet, që u përmendën në raport, si edhe nga relatori, pa dyshim, janë për t'u vlerësuar, sikurse eliminimi i tarifave të *roaming*-ut në Ballkanin Perëndimor. Ky proces filloi në Sofje në vitin 2018 dhe mbaroi më 1 korrik 2021, duke u bërë efektiv pas 3 vjetësh.

Ndërkohë, ju keni edhe "*road mape*", si e quani ju, nëse nuk gaboj, apo iniciativën e Këshillit të Rajonal të Kooperimit, siç quhet në gjuhën teknike, e cila në vetvete është reduktimi i tarifave *roaming* midis Ballkanit Perëndimor dhe Europës, por ka një problem, sepse kjo është në vullnetin e kompanive, është element komercial kompanish. Jam informuar nga mediet se ka një problem të ngurtësimit dhe mungesës së vullnetit nga palët.

Pyetja e parë është: a mendoni se kjo iniciativë do të ketë sukses?

E dyta, cili është roli i AKEP-it në këtë proces?

E treta, operacioni, ngjarja më e rëndësishme, që nuk përmendet në raport, ka qenë bashkimi i 2 operatorëve celular: ONE dhe Albtelecom, pavarësisht se është bërë efektive në vitin 2022 dhe ka pushtuar pa influenca tregun shqiptar. Kjo është ngjarja më e rëndësishme në fushën e telekomunikacionit dhe e komunikimit elektronik, por në raport nuk ka asnjë fjalë, sepse kanë qenë fazat e para.

Autoriteti i Konkurrencës e ka sanksionuar në shkurt të vitit 2022, ka dhënë miratimin për bashkimin e kompanisë "ONE" me kompaninë hungareze, që në vetvete është bashkimi i dy kompanive. Pra, tregu shqiptar i celularëve sot nuk do të jetë më me 3 operatorë, por me 2 operatorë.

Autoriteti i Konkurrencës ka lënë një rekomandim detyrimor: rishikimin e planit kombëtar të frekuencave me efekt riekulibrimin e spektrit të frekuencave, pasi frekuencat janë pasuri kombëtare.

Si rrjedhojë e bashkimit të dy kompanive, "ONE" dhe "Albtelecom", ka dyfishim të frekuencave, që për publikun, pasi ju jeni specialistë dhe e dini mirë, sjell një barrierë teknologjike dhe ekonomike për hyrjen potenciale të një operatori të tretë në treg. Nuk mendoj se jeni aq largpamës sa të dini nëse do të vijë apo nuk do të vijë një operator tjetër në Shqipëri. Ky është treg i lirë, apo jo? Në këto kushte, pyetja ime është: a ka marrë masa AKEP-i për balancimin e frekuencave, të cilat kanë efekt edhe te kostot e qytetarëve? Dua një opinion tuajin për perspektivën e tregut të telefonisë celulare pas këtij rikompozimi të tregut.

E fundit, më vjen keq ta them, por kjo pyetje tregon një segment abuzues të AKEP-it. AKEP-i ka funksion rregullator, nuk mund të jesh edhe operator në një treg, në çfarëdo segmenti

të tregut. Për cilin treg e kam fjalën? Ju e dini mirë, por po qartësoj kolegët. E kam fjalën elemente që lidhen me dhënien e *domain-eve*, sidomos me regjistrin dhe me regjistrarët. Normalisht, AKEP-i duhet të ishte enti rregullator. Një entitet tjetër duhet të kishte regjistrin e regjistrarëve, dhe menaxher i regjistrit, quajeni si të doni, do të licensonte, do të akreditonte regjistrarët, të cilët do të mbanin *domain-et* e tyre.

Çfarë ndodh sot në Shqipëri? I vetmi vend në Europë që ka këtë mënyrë, ju sfidoj të më jepni një vend tjetër. AKEP-i, që duhet të ishte rregullatori dhe monitoruesi, ka regjistrin e regjistrarëve; është vetë AKEP-i që luan edhe rolin e regjistrarit të operatorit. Kjo është njësoj sikur AKEP-i të marrë një licencë telefonie dhe të jetë operator telefonik. Është e turpshme!

Unë kërkoj nga ky komision i nderuar që si hap të parë AKEP-i të eliminojë akreditimin, të mos luajë si operator tregu dhe të mbajë vetëm rolin e rregullatorit, jo edhe të operatorit të tregut. Është e turpshme! Ju luani në të njëjtën fushë me ata që keni licencuar dhe akredituar vetë. A e kuptoni se çfarë do të thotë? Ka një abuzim të pastër me pushtetin, është disbalancim i tregut.

Zoti kryetar, kjo duhet të futet edhe te materialet që do të përgatisim për parlamentin.

Këto ishin 4 pyetje.

Do të kërkoj edhe një opinion nga ju në fund: pse po e disbalancoi tregun e *domain-eve*?

Arben Pëllumbi - Faleminderit!

Zoti Bushati, ne do të diskutojmë në një seancë edhe për rezolutën që do t'i paraqesim seancës plenare, ku ju do të mund të shprehni mendimin tuaj dhe ne do të jemi të detyruar ta diskutojmë. Sigurisht, nuk ka pse të jemi dakord, ose mund të jemi dakord, sigurisht pas një diskutimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot do të dëgjojmë zotin Frashëri.

Më pas ne do të kemi mundësi të diskutojmë për të gjitha temat që do të fusim në rezolutë për seancë plenare.

Zoti Frashëri, fjala për ju.

Tomi Frashëri – Faleminderit!

Zoti Bushati, faleminderit për pyetjet tuaja!

Nëse më lejoni, po e filloj nga pyetja e fundit, që të vijojmë më pas me një parashtrim të përgjigjeve.

Të paktën, nga ana e AKEP-it, deri diku, jo të shtendosur, por proaktive, në një lloj dialogu, situata e *domain*-eve është shumë e thjeshtë. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike Postare ka kompetenca ligjore. AKEP-i nuk i jep dhe nuk i heq vetes asnjë kompetencë që ia ka dhënë ligji. Unë do t'ju referoj nenin 8 të ligjit “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin thuhet: “AKEP-i administron *domain.al* duke qenë një të njëjtën kohë edhe regjistrar. Pra, mban regjistrin dhe është regjistrat.

AKEP-i nuk ka iniciativë ligjvënëse. Iniciativa ligjvënëse i takon qeverisë. Ju mund të merrni në shqyrtim këtë pikë me një propozim ligjor, nëse nuk gaboj, është shkronja “k” e nenit 8 të ligjit. Pra, neni 8 është selia e kompetencave të AKEP-it, aty janë radhitur të gjitha kompetencat ku thuhet se AKEP-i administron regjistrin dhe është regjistrar.

Çështja e tregut të *domain*-it, (nuk dua të marr shumë kohë për këtë, sepse për mendimin tonë nuk është debat), është shumë e thjeshtë: duke filluar nga çmimet që aplikon AKEP-i për të dhënë një *domain.al* si regjistrar, janë më poshtë dhe jo të orientuara drejt kostos, janë nën kosto pothuajse, janë më se të aksesueshme.

E dyta, nuk bëhet fjalë që AKEP-i operon. AKEP-i ka një sasi shumë më të vogël. Kryesisht janë institucionet qeveritare që marrin *domain.al* apo nën *domain*-et si: *gov.al*, *udu.al*, *mil.al* e të tjera,

Ka vende të tjera në botë me këtë sistem të ngjashëm.

Tregu është i liberalizuar në vitin 2008.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani nuk mund t'ju them, por mund ta gjej, sepse nuk është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti deputet, ju lutem!

Unë kam shumë respekt për ju, për këtë instancë, dhe po shpjegoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mund të isha kufizuar...

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bushati, ju bëtë pyetjet tuaja dhe zoti Frashëri do të japë përgjigje.

Helidon Bushati – Unë ju thashë: “Mund të më jepni një eksperiencë botërore”? Ti the: “Ka eksperiencia botërore”.

Tomi Frashëri – Zoti deputet, me shumë respekt, unë nuk kam nevojë ...

Helidon Bushati – Mos u referoni!

Tomi Frashëri – Po i referohem, sepse po ju përgjigjem juve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, ju i bëtë pyetjet tuaja.

Zoti Frashëri do të japë përgjigjet.

Në rast se ju nuk e merrni përgjigjen e pyetjes suaj, mund ta përsërisni derisa të jeni sqaruar për atë që bëni.

Tomi Frashëri – Unë nuk mund të kufizohem, zoti kryetar dhe zotërinj deputetë.

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, ideja e pyetjes së zotit Bushati nuk ishte nëse është ligjore kjo që bëni, sepse ju, sigurisht që veproni në bazë të ligjit, por cili është mendimi juaj për këtë gjë?

Tomi Frashëri – Zoti kryetar, unë nuk kam mendim, sepse jemi institucion. Institucionet nuk kanë opinione dhe mendime, por kanë kompetenca. Mosushtrimi i një kompetence nga institucionet është një shpërdorim detyre që dënohet me ligj.

AKEP-i nuk e ka në kompetencë *domain*-in përmes akteve rregullatore, nënligjore apo një praktike të mirë, por e ka në bazë të ligjit të votuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe, si i tillë, do ta zbatojë këtë kompetencë për aq kohë sa legjislatori do t’ia lërë të shkruar në ligj për të administruar regjistrin dhe për të qenë, njëkohësisht, regjistrar.

Dua thjesht të sqaroj se në këtë treg operatorët janë me qindra. Fakti është që nuk ka asnjë detyrim për regjistrarët, përveç vetëdeklarimit në regjistër. Pra, nuk ka detyrime, as rregullime ekzaktë, as tarifime nga ana e AKEP-it. AKEP-i thjesht mban një regjistër deklarimi, që është absolutisht i domosdoshëm edhe për çështje të inspektimit dhe të monitorimit. Ka disa detyra për regjistrarët në ligj dhe në rregulloren e *domain*-it në AKEP. Në bazë të të dhënave që mbledh AKEP-i, mund të bëjë monitorimin dhe inspektimin, që do të thotë zbatimin nga operatorët e detyrimeve ligjore që ata kanë. Pra, ky është një detyrim ligjor, është kompetencë ligjore. Për aq kohë sa është në ligj, AKEP-i do ta ushtrojë. I takon pushtetit ligjvënës, ndoshta qeverisë, të reflektojë për këtë çështje dhe patjetër do të nxjerrin konkluzionet që AKEP-i do t’i marrë parasysht, sepse do të zbatojë ligjin.

Mendoj se mund ta lëmë pjesën se cili shtet e ka dhe cili shtet nuk e ka, mjaftohemi te pjesa që është kompetencë ligjore dhe legjislatori e ka në dorë ta ndryshojë.

Më pas, po e marr në rend zbritës dhe po kaloj direkt te çështja e blerjes së shumicës së aksioneve në dy kompani të telefonisë së lëvizshme dhe fiks te njëra, nga një kompani hungareze, të shumicës së aksioneve. Jemi këtu, në këtë moment që flasim.

E para, nuk mund të refleктоhej në raport, sepse edhe kërkesa për autorizimet e nevojshme nga kompania hungareze ka ardhur ditët e fundit të dhjetorit, në mos gabo, dhe çdo institucion rregullator ka një afat që shqyrton kërkesën dhe notifikimet që i paraqiten për t'i marrë në shqyrtim; nuk mund të gjente vend në këtë raport dhe nuk ka se si të gjejë vend, për më tepër që jemi në një proces, nuk është i përmbyllur.

Çfarë ka ndodhur? Struktura aksionare e dy kompanive ka ndryshuar. Pra, është një transaksion komercial, i cili, si i tillë, nuk është në kompetencën e AKEP-it për t'u vërejtur në këtë stad, ndaj edhe AKEP-i ia ka referuar Autoritetit të Konkurrencës, që në bazë të ligjit të vet, sidomos nenit 12 për përqendrimit horizontale dhe vertikale, duhet të shprehet nëse e autorizon këtë ndryshim në strukturën aksionare, sepse deri në këtë moment, juridikisht, teknikalisht, nuk ka një bashkim të kompanisë "ONE" dhe "Albtelecom". Është një kompani e huaj, që ka maxhorancën e aksioneve në njërin dhe në tjetrën kompani. Për momentin kompanitë janë të regjistruara të ndara në qendrën kombëtare të biznesit, kanë strukturë menaxheriale të ndarë, kanë llogari të ndara, kanë klientë të ndarë, kanë numeracion të ndarë, gjithçka të ndarë. Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës, për të cilin AKEP-it nuk i takon të komentojë, thotë, për të gjithë ata që e lexojnë, se praktikisht e konsideron të mundshëm një *merge* i të dyja kompanive, eventualisht kur ajo të ndodhë. Në momentin që flasim, nuk kemi *merge*.

Çfarë do të thotë nëse nesër të dyja kompanitë vendosin të bashkohen dhe të krijojnë një kompani të vetme? Për AKEP-in do të thotë diçka: e vetmja kompetencë që ka AKEP-i në këto çështje është e parashikuar nga nenet 70-72 në ligj, që ka të bëjë me transferimin e frekuencave, sepse do të thotë se njëra nga dy kompanitë do të transferojë asetet e saj te kompania tjetër. Asetet kryesore janë të shumta, por njëra nga këto, që na intereson ne dhe juve, sepse është aset me vlerë kombëtare, është blloku i frekuencave, që në nivelet e ndryshme të spektrit, e disponojnë të dyja kompanitë. Pa asnjë diskutim që në momentin kur kompanitë do të vendosin të bëjnë këtë *merge*, do të parashtrajnë në AKEP kërkesën eventualisht për të autorizuar transferimin e këtyre frekuencave. Nëse nuk ka një autorizim nga AKEP-i, *merge* nuk ndodh. E

them këtë, që ta kuptojnë të gjithë që nuk ka *merge* për momentin, jo se nuk do të ndodhë, sepse kjo gjë u përket kompanive dhe ne nuk mund të paragjykojmë asnjë proces. Në këtë rast, pa dyshim, zoti deputet, AKEP-i do të marrë masa, i ka marrë që tani, praktikisht, sepse jemi në një punë shumë intensive për të parë, sepse është e paprecedent në Shqipëri, nuk është siç ka ndodhur me kompaninë “Plus” në një moment të caktuar, është tjetër gjë. Ne jemi duke parë, bëjmë takime të përjavshme teknike, për të parë mënyrën se si do të ndodhë ajo që quhet *refarm-in*, rishpërndarje e spektrit, dhe rebalancimi i spektrit. Është e vërtetë ajo që tha zoti deputet Bushati, që rreziku i një koncentrimi në spektër ekziston edhe për pasojë të krijimit të një barriere potenciale në nivelin e konkurrencës për hyrjen në treg të operatorëve të rinj, megjithëse duhet të vëmë re edhe një gjë, që nuk ka pasur interes nga operatorë për të hyrë në tregun shqiptar, qofshin këta operatorë klasikë, po themi, apo operatorë virtualë, të famshmit “MVNO”, për momentin që flasim. Jemi duke punuar për këtë. Ne jemi të angazhuar të kemi kontakt shumë shpejt me trupën e rregullatorëve të Bashkimit Europian dhe me struktura të Komisionit Europian, që merren me politikat e radio spektrium-it, në mënyrë që të gjejmë mundësinë teknikisht më optimale, edhe në dialog me operatorët, sepse zhvillimi i një operatori të telefonisë dhe fuqizimi është me interes për AKEP-in, është me interes për shtetin, është me interes për konsumatorin dhe, mbi të gjitha, është me interes për investimet e ardhshme, duke pasur parasysh se në këtë sektor praktikisht investuesi 100% është investitori privat. Kështu që, patjetër kemi punuar dhe e kemi në fokus dhe shumë prioritare mënyrën si do të gjendet mënyra teknike më optimale, sepse është shumë komplekse teknikisht. Mund të duket si diçka që thjesht mund të ndajmë një tabelë që dikush do të marrë këtë, apo do të lirosh këtë pjesë të spektrit, por është shumë më komplekse se kaq edhe për arsyen që, në të vërtetë, 2 operatorët e mëdhenj duhet edhe të përfshihen dhe të vijnë edhe ata me ide teknike, sepse ka lëvizje të spektrit.

“Vodafone”, për shembull, në shumë raste ndodhet në mes të “One Telecommunications” dhe “Albtelecom”. Pra, nëse do të ketë një rishpërndarje të spektrit pas një *merge*-i, do të duhet që “Vodafone” të zhvendoset, por këto janë çështje teknike për të evituar interferenca dhe për të mos cenuar cilësinë e shërbimit, pra në përdorimin sa më eficient të frekuencave. Janë gjëra inxhinierike, për të cilat as unë nuk jam personi më i përshtatshëm për të folur, sepse realisht është një botë më vete, por patjetër është prioriteti ynë numër një. Pse? Sepse ne e kemi kuptuar që duhet të paraprijmë një operacion të tillë, nëse ndodh. Pra, jo thjesht të presim, nëse ndodh ose jo, por duhet të jemi, pak a shumë, gati për këtë gjë dhe do të marrim mendimin

ndërkombëtar për çfarëdo lloj ribalancimi të spektrit, e përsëris, bëhet fjalë për trupën e rregullatorëve europiane, për aq asistencë sa do të duan të na japin dhe për RSPG-në, që është strukturë e Komisionit European për Radio Spectrum-in.

Kështu që, *merge*-in në vetvete mund ta shohësh në shumë pikëpamje. Është operacion që në Shqipëri, të paktën siç e shoh unë nga pikëpamja e tregut, nuk është një artificë, pra nuk është thjesht u desh, për arsye apo interesa, të ndodhte një blerje nga një kompani e 2 kompanive të tjera. Nuk duhet të harrojmë përmasat e tregut tonë, është treg shumë i vogël. Nuk duhet të harrojmë gjendjen e kolapsit ku ndodhej një nga këto dy kompani, e cila blerje apo jo, mund të thuhet që shanset i kishte shumë të mëdha për të dalë nga tregu një ditë dhe ndoshta të dalësh nga tregu në një mënyrë katastrofike, kjo pastaj është në gjykimin e specialistëve të fushës edhe më të mirë se unë. Në vend të kësaj që ndodhi, do të kishte qenë ndoshta më e rëndë dhe më traumatizuese për tregun, sesa një operacion, një transaksion tregtar, interesant, efektet e të cilit do të jenë në monitorim të vazhdueshëm.

Thashë, ne po përgatisim zgjidhje teknike dhe do të monitorojmë, bazuar edhe në vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë që mbikëqyrja e tregut të pakicës të na japë informacionet e duhura, nëse ndodh ky *merge*, nëse do të ketë impakt te konsumatori, nëse do të ketë impakt te çmimet. Për këtë do të duhet kohë, pasi të ndodhë dhe nëse ndodh *merge*-i, edhe për të marrë masat e duhura, mbi të gjitha masat *expost*, pra pasi ndodh fakti dhe ne ndërhyjmë, marrim masa administrative dhe vendosim ekuilibra, ose sigurisht, në raste të caktuara, mund të mendohet përmes analizave të tregjeve, të shihet edhe mundësia e rregullimeve pak më të sforcuara, të cilat nuk janë më në modë askund, ndjesë për termin, por që nuk janë të përjashtueshme si instrumente rregullatore të Autoritetit. Pra, këtu jemi. Thjesht, edhe njëherë, janë vlerë maxhoranca e aksioneve në të dy kompanitë, nuk ka *merge* për momentin, një *merge* potencial duket i autorizuar nga Autoriteti i Konkurrencës. AKEP-i ka filluar të marrë masat teknike për të rishikuar përdorimin eficient të spektrit dhe balancimin e konkurrencës në këtë aspekt.

Vijmë te pyetja e dytë, lidhur me *roaming*-un dhe *roadmap*-in. *Roaming*-u rajonal është një proces, që siç e përmendët edhe ju, ka filluar në samitin e Sofjes në vitin 2018. Nuk është se nuk është bërë asnjë gjë nga viti 2018 deri në vitin 2021. Ka qenë një fazë shumë e gjatë përgatitore, e dakortësuar me marrëveshje ndërqeveritare, që është “*Roaming like at home plus*”, ndjesë edhe njëherë, “*Roaming-u si në shtëpi plus*”, i cili lejonte përshtatjen qoftë të

instrumenteve rregullatore, pra përmes tarifimit të caktuar dhe përmes unifikimit të tarifave, qoftë edhe operatorëve, në mënyrë që të gjithë të siguronin pjesën teknike dhe financiare të kalimit në një *roaming* 100%, pra me 0 tarifa, dhe kjo ka qenë faza që thashë, e cila është në marrëveshjen ndërqeveritare e përcaktuar kështu. Pra, që në 1 korrik të vitit 2021 nuk është shtyrë si proces.

Kemi pasur partnerë që kanë dashur ta shtyjnë këtë proces, jo në Shqipëri, por jashtë, për të qenë i saktë në një vend të Ballkanit Perëndimor, por kjo nuk është pranuar, sidomos nga pala shqiptare dhe kemi bërë të pamundurën që më 1 korrik 2021, sipas marrëveshjes ndërqeveritare, pa asnjë shtyrje, të hynte në fuqi. Thjesht, kujtoj që është një përfitim shumë i madh për qytetarët shqiptarë, një gjë deri diku e pazakontë, sepse iniciativa të tilla janë kryesisht rakordime tregtare në nivele të Bashkimit Europian. Vetë Bashkimi Europian ka probleme të mëdha, rinovoi me vështirësi marrëveshjen e vet të *roaming*-ut brenda vendeve anëtare, sepse ka pasur shumë debate dhe është një sukses i padiskutueshëm. Nuk është një sukses i AKEP-it. AKEP-i ka qenë një aktor, si shumë të tjerë. Për mua është sukses i madh i operatorëve, që nuk e humbasin nga fokusi interesin njerëzor të konsumatorit dhe gjithashtu e llogarisin dhe e kuptojnë shumë mirë rëndësinë politike, ekonomike dhe të zhvillimit të qëndrueshëm nga kjo gjë. Kështu që, pyetjen për *roaming*-un në Ballkanin Perëndimor besoj se e qartësova. Jemi mirë, tarifat janë 0, përveç pjesës së konsumit të internetit, që aplikohet një *fair use policy*, pra politika e përdorimit të drejtë, që të mos abuzohet, sepse vetëkuptohet që ka kosto.

Për sa i përket *roadmap*-it, kjo është një iniciativë që i takon kryesisht Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal dhe është një iniciativë jashtëzakonisht interesante, shumë kërkuese, shumë ambicioze. Është e saktë ajo që Komisioni Europian ka bërë të qartë, që nuk mund të implementohet përmes një marrëveshjeje ndërqeveritare. Kjo sepse në një nivel kaq të madh, ku janë rreth 100 operatorë të Bashkimit Europian dhe një numër i caktuar operatorësh në Ballkanin Perëndimor, me praktika të ndryshme tregtare, me metodologji të ndryshme të vlerësimit të kostove, me marrëveshje midis tyre, një marrëveshje ndërqeveritare e këtij kalibri do të binte ndesh me rregullat e tregtisë ndërkombëtare. Kjo nuk është thënë, sepse po ta marrim nga pikëpamja shqiptare, ne do të ishim shumë të lumtur të kishim marrëveshje ndërqeveritare, sepse do ta na lehtësonte jetesën, por Bashkimi Europian nuk ka gjetur dakortësi për këtë, bien ndesh me rregullat e tregtisë ndërkombëtare. Atëherë, çfarë bëjmë ne? Ne bëjmë një *roadmap*, i cili ka për synim final zerimin e tarifave, pra sigurisht do të ketë faza reduktimi, por qëllimi, zoti

deputet, është zerimi, siç u bë brenda Ballkanit Perëndimor. Në fakt, ky *roadmap* ka një rëndësi si proces në vetvete, sepse ndërthuret me një sërë nevojash që kemi ne si rajon, ne si Shqipëri patjetër po, por jemi të përfshirë në një rajon më të gjerë, siç është Ballkani Perëndimor, në mënyrë për të incentivuar investimet, për të sjellë modifikimet e nevojshme ligjore, sepse janë të domosdoshme.

Ka shumë nevojë për rishikim të disa paketave tona ligjore, që nga lejet e ndërtimit; nga pjesa e të drejtës së kalimit; nga pjesa e bashkëpërdorimit të infrastrukturës; por mbi të gjitha intencivimin e investimit privat në një vend që ka probleme si Shqipëria, deri te terreni i tij që është malor. Është një proces i tërë që shkon paralel me shumë detyrime që u vjen shteteve, qeverive, rregullatorëve dhe operatorëve për të arritur këtë *roaming*, sepse ky *roaming* nuk duhet të jetë shkatërrimtar për financat e operatorëve dhe nuk duhet të jetë një dështim, një artificë, që nesër të mos funksionojë.

Roadmap-i është shumë i gjerë. Ai përfshin detyrime që ne kemi edhe nga plani kombëtar “*Broadband*”, detyrime që kemi nga progresraporte, detyrime që kemi nga angazhimet tona në kuadër të integritimit europian. Sigurisht ka një *dateline*, që është një proces që do të zgjasë 5 vjet, ndoshta edhe më shumë.

Dy pikat kryesore që dua të them, për çështje kronologjie, janë: e para, secili duhet të bëjë detyrën e vet dhe, mbi të gjitha, shtetet vërtet nuk do të angazhohen në marrëveshjet ndërqeveritare, por duhet të japin të gjitha incentivat në mënyrë që operatorët të kenë parashikueshmëri për investimet dhe të kenë parashikueshmëri për rentabilizimin ose, si të thuash, për reduktimin e humbjes së tyre financiare që do të okazionojë eventualisht kalimin në një tarifim 0 me vendet e Bashkimit Europian dhe pika e dytë është detyra e operatorëve, të cilët duhet të hyjnë në marrëveshje, në diskutime me operatorët e Bashkimit Europian, që thashë janë 90, ose 100, pra janë shumë, secili me kapacitetin dhe praktikën e veta tregtare dhe ne do të jemi aty për të ndihmuar. Si ndihmojmë ne? Ne ndihmojmë nëpërmjet koordinimit të dialogut, ne ndihmojmë në nivel lokal mes rregullatorëve, i ulim operatorët dhe flasim me ta, ndihmojmë duke bërë “*naveta-n*” midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe trupës europiane të rregullatorëve, që është BEREK-u, që e përmenda, dhe secili nga rregullatorët europiane, që merr pjesë në BEREK, mund të bëjë të njëjtën punë me operatorët e BE-së, secili në vendin e vet, në mënyrë që të harmonizohet qasje për marrëveshjet që do të ketë secili operator. Pra, është një proces shumë interesant. *Roadmap*-i është vërtet i hartuar shumë mirë dhe neve na jep

mbështetje, jo vetëm për një Roaming të ardhshëm me vendet e BE-së, na jep mbështetje për të shtyrë aktorët publikë, qeveri kryesisht, për të krijuar kushtet e intencivimit të investimeve, që për ne janë shumë të rëndësishme.

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, të lutem, e kuptoj që këto janë tema që kërkojnë një lloj shtjellimi për t'u kuptuar saktë, por gjithsesi kohën në dispozicion e kemi të kufizuar dhe jemi akoma në pyetjet e para. Duke pasur parasysh edhe interesin e të gjithë kolegëve, ju lutem, sa më shkurt dhe në rast se ndonjëri nga kolegët do të dojë më shumë shpjegime, mund të hyjë në kontakt me ju, nëpërmjet Komisionit, për të pasur një informacion më të detajuar, kështu që, më të përmbledhura përgjigjet. Faleminderit!

Tomi Frashëri – Dakord.

Kërkoj ndjesë!

Është gjithmonë prirja për të qenë sa më shterues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni edhe një pyetje? Aty po vij, te pyetja e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se këtu ka nevojë për një sqarim. Plani Kombëtar Broadband është miratuar në vitin 2020. AKEP-i nuk ka marrë angazhim për ta rishikuar Planin Broadband, sepse ai është thuar se i sapomiruar dhe realisht kushdo, që e ka parë atë dokument në instanca ndërkombëtare, ka dhënë vlerësimin maksimal, sepse në fakt është një dokument shumë i mirë dhe atë dokument e miraton pa dyshim qeveria shqiptare, nuk e miraton AKEP-i. Këtu AKEP-i, siç thotë ligji, ndjek politikat sektoriale të qeverisë, sepse kjo lidhet sigurisht me pjesën e zonave rurale, me pjesën e mbulimit dhe të gjitha me radhë.

Plani kombëtar “*Broadband*” ka dhënë disa orientime dhe disa detyrime shumë të qarta, si duhet të procedohet për një mbulim. Te ky mbulim duhet të bëjmë një dallim, jo vetëm në bazë të terrenit, por edhe në bazë të medimeve, pra, kemi mbulim *mobile* dhe mbulim *fix*. Mbulimi i lëvizshëm, ose *mobile*, në Shqipëri është i zgjidhur, e thamë që rrjetet 4G kanë përparuar deri në 95% të territorit. Tani është çështja e *fix*-it, pra, është çështja e mbulimit, është çështja e “*Broadband*”-it, është çështja e infrastrukturës për të çuar internetin sa më larg dhe sa më lart të jetë e mundur, sepse ka vende, si në pjesën e Malësisë, në veri, ku ka gjithmonë probleme të mbulimit, sepse është terreni i aksidentuar, është largësia e zonave e të tjera. Patjetër plani “*Broadband*” nuk ka nevojë të rishikohet, sepse është shumë i qartë në atë çfarë kërkon.

Për sa i takon kësaj pjese, ju ndoshta nuk jeni në dijeni, por qeveria shqiptare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nisur një proces shumë të komplikuar me Bankën Europiane të Investimeve, që edhe ai është në fund të fazës së fizibilitetit për mbulimin e të ashtuquajturave “zona të bardha”, të cilat janë pothuajse 100% zona rurale, që kanë probleme me ndërlidhjen, sidomos me pjesën e mbulimin “*Broadband*”.

Në periudhën kur ka nisur, 2-3 vjet më parë, është dhënë një shifër prej rreth 2000 fshatrave, por sot është shumë e vështirë të gjejsh 2000 fshatra që nuk kanë internet, janë shumë më pak, pasi e gjithë Shqipëria ka praktikisht 2000 fshatra. Është nisur për të qenë shumë ambicioz, që cilësia të jetë sa më e lartë në të gjitha fshatrat e Shqipërisë. “Zonat e bardha” kanë ardhur gjithmonë duke u reduktuar, sepse fibra përparon, dhashë edhe shifrat sa ka përparuar fibra këtë vit, dhe kjo është një nga pikat kryesore, ku ne jemi të fokusuar.

Besoj se raporti i vitit të ardhshëm do të ketë gjëra interesante në këtë aspekt. Ka opsione që shkojnë që nga mendimi për të ndërtuar një infrastrukturë kombëtare *Broadband*, deri te një optimizim i çfarë ekziston në kapacitete fibre sot. Janë 260 ISP, Internet Service Provider, për ata që japin internet *fix*, do të thotë që treg më të madh se ky nuk ka. Edhe këtu ka një anomali dhe ne po punojmë, që edhe kjo të racionalizohet, sepse janë shumë. Janë disa opsione, gjithsesi po punohet njëherë për të gjetur një zgjidhje teknike për “zonat e bardha”. Është ky projekt i qeverisë shqiptare dhe ne jemi vetë që japim konsulencën tonë atje.

E dyta, vetë AKEP-i është duke menduar se kush është më optimalja, e thashë edhe njëherë, shtimi i një infrastrukture, sepse ka një infrastrukturë që ekziston, Telecom-i ka një infrastrukturë, ka kompani të tjera që kanë ngritur infrastrukturë të tyre apo ka zgjidhje të tjera, në mënyrë që të ulen kostot e investimeve dhe të optimizohet përdorimi i fibrës, kështu që e kemi shumë në fokus këtë gjë. Edhe një nga shtyllat strategjike, që ne kemi propozuar dhe ju mund të merrni edhe shkas për rezolutën, është çështja e fillimit të analizës të tregjeve *broadband*, pra, ne duam të kemi edhe një panoramë shumë të qartë se “kush bën çfarë” në *broadband* dhe në infrastrukturë në këtë vend. Ka ardhur koha të bëhet kjo analizë tashmë dhe sigurisht pas kësaj analize do të dilet me hapa shumë interesante.

Ju falënderoj për pyetjen! Nuk është një nga shqetësimet, por është një nga pikat ku ne duhet të avancojmë brenda mundësive, duke pasur parasysh mundësitë e vendit, sepse nuk kemi një treg të jashtëzakonshëm dhe duhet të japim, të marrim me investitorët dhe me operatorët. Këtë mund të them.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Kishit diçka? Po, shkurt, ju lutem!

Helidon Bushati – Zoti Frashëri, 2 elemente: kur ju bëra pyetjen për sa i përket bashkimit, ju u përgjigjet duke bërë, pak a shumë, orakullin e tregut, se ndoshta Albtelekomi do të dilte. Nuk është këtu vendi për të bërë orakullin e tregut për të legjitimuar një marrëveshje që ka bërë Edi Rama, aty ku e ka bërë. Problemi këtu është që ju të ndërhyini jo *ex-post*, por *ex-ante*.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ex-ante për sa i përket konfigurimit që duhet të ketë rrjeti. Këto janë gjëra teknike. Ju vetë e pranuat moskompetencën, aq më pak edhe unë nuk jam kompetent, por mos bëni orakullin e tregut, bëni atë që ju ka përcaktuar ligji.

Për sa u përket dispozitave që ju ka përcaktuar ligji, shpresoj se ju bëtë një lapsus, sepse pranuat që AKEP-i po bën *dumping*, po shet *domaine* nën kosto, e pranuat ju vetë. AKEP-i nuk duhet të bëjë jo vetëm *dumping*, që është procedurë antiligjore ekonomikisht në princip, por nuk duhet të jetë operator i tregut. Që të vijë këtu kryetari i AKEP-it dhe të pranojë me gojën e vet : “Po bëj *dumping*” te pjesa e domeneve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem! E pranuat ju, ju thatë kështu. “Unë e shes nën kosto”. Shitja nën kosto, sidomos nga një entitet rregullator, quhet *dumping*, është koncept ekonomik. E shpjegon ti ose jo, ky është koncept ekonomik. Prandaj, në vend që të merreni me *dumping*-e, mos mbani *domaine*, dhe nën *domaine-t* gov, net e të tjerë. Mund t’i mbajë shumë mirë AKSHI, jo ju. Ju jeni ent rregullator.

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tomi Frashëri – Zoti kryetar, një sekondë, ju lutem!

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, një minutë, do t’jua jap unë fjalën.

Tomi Frashër – Dakord.

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, ju lutem!

Nuk i shërbejnë kujt tonet e larta.

Zoti Frashëri, nuk ikën, këtu është. Për çdo gjë që ju vazhdoni të mos jeni i qartë, do të vazhdojmë ta pyesim e të marrim përgjigjet. Unë nuk besoj se zoti Frashëri ka ardhur të bëjë

orakullin, por, nga ana tjetër, mos bëni policinë sekrete, sikur dini çdo gjë që ndodh në këtë vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por, nëse e di e gjithë Shqipëria këtë, e di e gjithë Shqipëria edhe atë tjetrën. Prandaj, ose ta mbajmë në balancë të gjithën ose “ e dimë të gjithë edhe këtë, edhe atë”.

Zoti Frashëri, nëse keni diçka për të shtuar, ju lutem shkurt, sepse janë shumë kolegë të tjerë që duam ta marrin fjalën!

Tomi Frashëri – Zoti kryetar, kam vetëm një kërkesë, unë vij me shumë respekt në Kuvendin e Shqipërisë, pasi është autoriteti që më mandaton dhe më kontrollon. Unë nuk jam as njeri politik dhe as autoritet politik. Nuk jam anëtar i qeverisë së Shqipërisë dhe nuk jap llogari si i tillë në Kuvend. Jap llogari për punën rregullatore, të cilën e zhvilloj, e përsëris, në bazë të legjislacionit në fuqi. Nëse 1, 2, 3, 10, 140 deputetë të parlamentit të Shqipërisë konsiderojnë që germa “k” e nenit 8 të ligjit 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” është tejkaluar, është e tepërt, secili mund të ketë gjykimin e tij që të propozojë ndryshime ligjore. Transpozimi i direktivës së BE-së, i Kodit të Komunikimeve Elektronike, i cili do të vijë në Kuvend herët apo vonë, do ta modifikojë rrënjësisht ligjin “Për komunikimet elektronike” në fuqi dhe do t’i japë shansin legjislatorit, që jeni ju të gjithë bashkë, secilit prej jush të bëjë propozimet e tij për ta modifikuar këtë ligj. E përsëris, kur thashë nën kosto, nuk është në nocionin e shkallës, por është në nocionin e aksesit në këtë shërbim, është një shërbim që ka një pagë pothuajse simbolike për sa i përket AKEP-it. Po të ishte se ne do ta bënim nën kosto, do të ishim regjistrari më i madh në Republikën e Shqipërisë. Ne jemi regjistrari më i vogël në Republikën e Shqipërisë. Regjistrarët privatë janë kryesorët. Ne jemi regjistrari më i vogël dhe do ta ushtrojmë këtë kompetencë, për aq kohë sa ligji na jep.

Për sa i takon pastaj, zoti Bushati, pjesës së orakullit, sesa njeh AKEP-i nga brenda një operator, me shumë respekt, mendoj se nuk i njeh shumica në këtë republikë. Unë nuk bëra orakullin, duke thënë se do të dilte. Orakulli kur shprehet, nuk shprehet me “ndoshta”, shprehet se do të ndodhë. Për pasojë, nuk jam as orakull në këtë nivel. Thjesht thashë që analiza e asaj kompanie, ishte e tillë që me borxhet që kishte dhe me pamundësitë për t’i paguar, detyrimet e mbikëqyrjes së tregut dhe përdorimit të radiofrekuencave në AKEP nuk shlyheshin, nuk kishte më likuiditet. Unë nuk dua të hyj tek ajo analizë, sepse nuk më takon. Thjesht thashë, ndoshta, mund të ndodhte. Ajo do të kishte qenë shumë traumatizuese për tregun. Kaq mund të them unë.

Si rregullator, kam për detyrë të bëj analiza prospektive. Të shikoj se ku do të jem që të jemi të qartë.

Arben Pëllumbi – Jemi të qartë.

Faleminderit për këtë pjesë!

Ismet Beqiraj – Përshëndetje ju, zoti Frashëri, dhe stafit tuaj!

Ne sot po diskutojmë raportin vjetor të një institucioni që ka në veprimtarinë e tij një teknologji që Shqipëria e përthithi shumë shpejt, ku u larguam nga antenat me parabolë, nga telefonat me tela dhe jemi ne periudhën e Shqipërisë digjitale, në të gjitha aspektet e shërbimit. Kjo është një e mirë publike në radhë të parë; nga ana tjetër, edhe përthithja e teknologjisë së re digjitale është një benefit i madh ekonomik dhe një mirësi e madhe publike. Si e kemi përfituar publikisht këtë gjë në periudhën e pandemisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk i ndërhyj asnjërit. Fole sa deshe, bërë komente, pastaj pyetje. Kjo është e para.

Mund të ketë mangësi plot, por 2 vjet pandemi e vërtetuan më së miri implementimin e kësaj teknologjie në mësimdhënie, në komunikim, në kryerjen e veprimtarisë ekonomike, shoqërore, parlamentare dhe në vendin tonë. Prandaj, nuk duhet të nxijmë gjithçka.

Nga ana tjetër, dua ta lidh me 2 gjëra konkrete, nuk do të hyj në terma teknikë, që specialistë të fushës i përkthejnë tamam, përvese konsumatori. Unë kam diçka për pjesën e parë që lidhet me shërbimin universal për komunikimet elektronike.

E para, në sa për qind të territori të vendit është siguruar një shtrirje dhe akses maksimal i rrjeteve dhe infrastrukturës së shpejtësisë së lartë? Se tani njerëzve u është shtuar oreksi në këtë drejtim. Lidhur me këtë, rrjeti i komunikimeve elektronike ekzistuese siguron një garanci shërbimi në të gjithë territorin e vendit dhe një mundësi për të implementuar atë, që është miratuar para 2 vjetësh edhe në ligjin zgjedhor, pra futjen e sistemit të digjitalizimit në të gjithë procesin e zgjedhjeve deri në votim?

Përsëri për këtë shërbim do të bëj edhe një pyetje tjetër. Çfarë duhet të bëjë AKEP-i për të reduktuar nivelin aktual të tarifave të shërbimit për internetin?

Lidhur me shërbimin universal postar, që ka marrë shumë shërbime dhe është për t'u vlerësuar që i ka ndërruar fytyrën këtij shërbimi shumë të rëndësishëm në radhë të parë publik, si mendoni, ose cili do të jetë ndikimi juaj që ky shërbim të liberalizohet për tërheqjen e pensioneve pranë çdo sporteli të Republikës së Shqipërisë nga pensionistët, në mënyrë që të mos shikojmë

më radhë, si në kohën e qumështit, te një sportel i vetëm, por ata të kenë akses t'i tërheqin pensionet e tyre në çdo sportel të postës shqiptare, në çdo territor të Republikës së Shqipërisë? Mjafton të kenë një kartë, që do të prodhohet apo me kartën e identitetit të tyre, pra të mos i stërmundojmë.

Nga ana tjetër, mund të shtrihet, të implementohet në të gjithë Shqipërinë një shërbim tjetër që ka të bëjë me zyrat postare për përfitimin e benefiteve ekonomike që jepen në bazë të vendimeve që marrin bashkitë. Me sa jam në dijeni, një implementim i tillë është bërë në filialin e Durrësit dhe ka dalë i suksesshëm. Pse të mos shtrihet në të gjithë vendin, por të gjithë banorët e një bashkie të madhe, bie fjala, si Tirana, të shkojnë vetëm te sporteli në qendër të bashkisë?

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Zoti Frashëri.

Tom Frashëri – Atëherë, po e filloj nga fundi, për sa u përket shërbimeve postare, duhet thënë se kompetenca rregullatore e AKEP-it nuk shtrihet te shërbimet financiare ose shërbimet jashtë dërgesës, marrjes, trajtimit dhe përpunimit të objekteve postare, prandaj, për pasojë, nuk e ka në kompetencë, në asnjë mënyrë çështjen e shtrirjes, zhvillimit, zgjerimit të disa shërbimeve që kanë të bëjnë me ofrimin e disa lehtësive ndaj shtresave të caktuara të popullsisë. Kjo është një gjë që besoj se përfaqësues të postës shqiptare si shoqëri, mund të japin të dhëna. Kur themi shërbimi universal në raport, ai është një nocion shumë preciz që ka të bëjë me minimumin e cilësisë, minimumin e shtrirjes, minimumin e ofrimi të shërbimi, për ta thënë trashë, dhe çmime gjithmonë të orientuara drejt kostos, në këtë rast në nocionin e saktë ekonomik vetëm për pjesën e aktivitetit postar të mirëfilltë, pra dërgim të objekteve postare, marrje, përpunim dhe shpërndarje të tyre.

Për pasojë, jam i keqardhur që nuk mund të them më tepër për çështjen e shërbimeve të natyrës financiare apo mbështetëse të popullsisë përtej shërbimit postar të mirëfilltë.

Për sa i përket pjesës së digjitalizimit dhe shërbimit publik, nuk di si ta quaj të votimit *online*, kjo nuk është çështje rrjetesh, por sistemesh; bëhet fjalë për instalim sistemesh të caktuara, të financuara, nuk e di se në çfarë mënyre, nga qeveria, nuk dua të futem këtu, sepse nuk e kam shumë idenë se për çfarë bëhet fjalë, por ajo që mund t'ju them është kjo: nëse një gjë e tillë ndodh, patjetër që operatorët e kanë kapacitetin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Besoj se do të ketë pika votimi për njerëzit që nuk disponojnë ndoshta facilitete për të aksesuar në internet në shtëpitë e tyre, por nuk di sesi mund të ndodhë, sepse kjo është çështje

e organizimit territorial dhe i takon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ta përcaktojë, por ajo që ne mund të garantojmë është që operatorët do të mbahen nën presion, sepse edhe këtu AKEP-i nuk ka funksion policor tek operatorët, do të jetë presioni i duhur, por edhe operatorët e kuptojnë shumë mirë rëndësinë e disa proceseve për të mirëfunksionuar të pakën nga pikëpamja e rrjeteve se si sistemet do të jenë performues në vetvete. Mund të kenë probleme të sigurisë kibernetike, mund të kenë probleme të funksionimit teknik, ato janë probleme që nuk kanë të bëjnë me rrjetet. Rrjetet do të funksionojnë. Ky është fakt, por e sigurt.

Ju bë të një pyetje në lidhje me uljen e çmimeve për internetin, të paktën, krahasuar statistikisht me shumë vende të tjera, kryesisht me vendet e rajonit, ne jemi një nga vendet ku çmimet gjithmonë vijnë e ulen nëpërmjet paketave, sigurisht, pra, në terma paketash, në terma ofertash çmimet edhe njësitë telefonike, por edhe aksesit në internet. Gjithmonë interneti vjen duke pasur shpejtësi e cilësi më të lartë, do ta ketë dhe më të lartë, kur një ditë të implementohet 5 G-ja në këtë vend, janë relativisht çmime stabilë, çmime nuk po them të ulëta, se ajo nuk ka fund, por janë çmime që janë konform realiteteve të tregut.

Dua të them edhe një gjë, nëse do të keni kohë, të shikoni raportin e vitit 2020, ku një punë shumë e madhe u bë gjatë pandemisë, një punë aq e madhe, sa nuk ishte më problem për të pasur rrjet, por problemi i njerëzve ishte për të pasur tableta dhe telefona celularë për të ndjekur mësimin, sepse rrjeti u *bustua*, nuk e di sesa fish, aq sa patëm problem mos kishte *congestion*-im të rrjeteve dhe një problem kolapsi të tyre. Ajo që u bë gjatë pandemisë nga operatorët është një gjë e jashtëzakonshme, sepse e thashë edhe një herë që rrjete pati, por pastaj operatorët filluan të ofronin vetë tableta dhe telefona për nxënësit për të ndjekur mësimin *online* dhe të tjera me radhë. Rrjeti nuk mungoi kurrë, nuk pati asnjëherë kolaps, siç pati në vende të tjera, si: Itali, Britani e Madhe, madje edhe SHBA-të. Prandaj, çështja e cilësisë së shërbimit të rrjetit dhe çështja e çmimeve janë interesante. Gjatë pandemisë ne arritëm të vendosim bashkë me Autoritetin e Konkurrencës paketa 5 mijë lekë të vjetra, për shtresat më në nevojë. Unë jam i lumtur të shoh që operatorët, megjithëse periudha më problematike e pandemisë ka kaluar, kanë vazhduar t'i mbajnë këto paketa për shtresat më në nevojë, bëjnë praktikisht rolin e shërbimit universal. Pra, ka një minimum aksesit në internet, një minimum në cilësi, një minimum në përballueshmëri e të tjera me radhë. Këto ekzistojnë. Kjo është prej vullnetit të operatorëve, sepse ne nuk mund ta imponojmë më një gjë të tillë. Besoj se nuk jemi dhe aq keq në këtë aspekt. Sigurisht që pastaj, me zhvillimin e shërbimeve, me rritjen e konkurrencës në treg, që

është gjithmonë në rritje, tregu është goxha dinamik, këtë mund t'jua garantoj, aq sa krijon probleme menaxhimi i këtyre dinamikave, nuk është një treg i ndenjtur, kjo është e sigurt, gjithmonë çmimet do të vijnë duke u ulur, sepse konkurrenca këtë ka që në pakicë fillon pastaj dhe impakton pozitivisht çmimet.

Pyetja e fundit, por që praktikisht e mori përgjigjen mbulimit. E mori përgjigjen, kur ia dhashë zotit Bushati. Ne jemi në 95 % të territorit – këto janë raporte të ITU-së, nuk janë raportet tona – pra jemi ndër mbuluesit më të mirë në rajon e më gjerë.

Në lidhje me pjesën e shtrirjes së fibrës, pjesën e zhvillimit të broadband-it, jemi në studim e sipër. Po shohim mundësitë më të mira, duke u nisur nga terreni i vendit, por dhe nga mundësitë e investimeve, që mbulimi të fillojë të zgjerohet. Brenda një viti kemi kaluar në fibra 46 % në 56 % të lidhjeve, që do të thotë se është goxha shumë për një vend si Shqipëria. Pra, jemi në proces. Këto janë procese të digjitalizimit, që ecin shpejt, por gjithsesi kërkojnë kohën e vet për mbulim. Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Meqenëse e përmendët ju, dhe këtu nuk po flas si kryetar komisioni, por si deputet, në lidhje me shqetësime që dëgjojmë lart e poshtë, në zonë, është e vërtetë që u bë ajo paketa pesëmijëlekëshe gjatë kohës së pandemisë, e cila pati një sukses shumë të madhe na të periudhë, e që u mbajt. Megjithatë, shqetësimet që na vijnë sot janë që paketa pesëmijëlekëshe nuk ofron më të njëjtën sasi interneti. Thuhet se do të kesh një giga, por në fakt ajo mbaron shumë shpejt. Ky është një shqetësim, që unë nuk e di sa i vërtetë dhe sa i saktë mund të jetë, por është një shqetësim që e kemi dëgjuar. Ndoshta edhe përmes rekomandimeve që do të japim, do të donim t'i kishit në vëmendje këto. Ne e kemi thënë edhe në raportin e 2021-shit, mbase do të jetë edhe në raportin tjetër, por kjo duhet të jetë një punë e vazhdueshme juaja, për të parë këto çrregullime që mund të vijnë në treg në lidhje me çfarë thuhet dhe çfarë ofrohet në realitet. Ky ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm, por meqenëse më ngacmuat me këtë, m'u kujtua se shumë qytetarë të ndryshëm e kanë shprehur këtë shqetësim. Vazhdojmë me zotin Gështenja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur ta merrni fjalën, mund të shpreheni.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke marrë shkas nga fjala e zotit Frashëri, si titullar i institucionit, them se mbase jemi duke e paragjykuar institucionin, sepse qenkemi në një botë joreale. Me sa dëgjova deri tani, na

rezulton që, sa i takon kësaj fushe, ne qenkemi vendi më i zhvilluar në Europë, se në Ballkan po e po.

Gjithsesi, unë dua t'i drejtoj disa pyetje zotit Frashëri, lidhur me atë çfarë unë shoh në raport. Pavarësisht vështirësive që solli situata e zgjatur e pandemisë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar rregullisht, thuhet në raport, dhe në shumicën e rasteve është kualifikuar çmimi më i ulët. Ndërkohë, në mos gaboj, rezultojnë rreth pesëmbëdhjetë procedura, të cilat janë në sistemin e APP-së, dhjetë prej të cilave kanë qenë pa garë.

Unë nuk e di për ju, si titullarë, por edhe si institucion, çfarë kuptoni me “vlera më e ulët”, kur në një procedurë nuk ka garë, kur është vetëm një operator? Në pesë procedura të tjera vlerat e ofruara janë nga 98 % deri në 100 % e fondit limit. Flas për pesë procedura, ku presupozojmë se ka pasur garë. Kjo është e para.

E dyta, sipas të dhënave të INSTAT-it dhe të AKEP-it, ka një rritje të theksuar të përdorimit të rrjetit celular, që mundëson akses edhe në rrjetin e internetit. A është reflektuar kjo rritje e përdorimit në uljen e çmimeve, krahasuar me një vit më parë?

Një nga problematikat thelbësore, që shqetësojnë qytetarët në lidhje me dëmtimin e shëndetit si pasojë e rrezatimit, janë antenat e vendosura mbi pallate apo mbi institucione publike, kjo kryesisht në Tiranë, por edhe në rrethe. A ka kryer AKEP-i studime për këtë qëllim? A ka ndonjë plan për zhvendosjen e këtyre antenave në zona jo të banuara?

Një nga rekomandimet e Kuvendit për vitin 2021 ka qenë dhënia në përdorim e lotit të mbetur të frekuencës 800 megaherc, në mos gaboj, që në raport nga njëra anë pranohet si rekomandim i realizuar, por nga ana tjetër pranohet se nuk ka pasur shprehje interesi nga operatorët celularë për marrjen në përdorim të këtij spektri. A është dhënë në përdorim ky spektër apo jo?

E fundit: A ka pasur AKEP-i raportime në Autoritetin e Konkurrencës, dhe në lidhje me çfarë çështjesh? Çfarë masash janë marrë nga ana juaj? Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Gështenja!

Zoti Frashëri!

Tomi Frashëri – Garën nuk e bën pjesëmarrja. Gara është garë. Merr pjesë ose nuk merr pjesë në të, gara do të zhvillohet, sepse është detyrim ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Mund të mbaroj? Mund ta parashtroj atë që dua të them?

Tani çfarë ndodh? Në fund të ditës, edhe në Kuvend ka një garë për President. Gara hapet. S'ka garues. Vazhdohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'po bëj politikë. Është procedurë ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se është radha ime për t'u përgjigjur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të bëj edhe unë ndonjë analogji herë pas here. Është diçka që juristët e njohin si praktikë. Procedurat janë zhvilluar në mënyrën më transparente të mundshme. Gara është ligjore dhe ka afatet e veta për t'u bërë. Si titullar institucioni, unë kam detyrimin të ekzekutoj investimet që më janë përcaktuar në buxhet për secilin zë në investime, që buxheti më ka detyruar të realizoj. Kjo është detyra ime kryesore. Nëse unë nuk realizoj detyrimet buxhetore dhe ligjore që kam, atëherë unë nuk e kam kryer detyrën time.

E dyta, tregu i *suppliers*, ndjesë për termin në anglisht, por po them tregu i furnizuesve të shërbimeve për sisteme teknologjike apo për konsulencat të caktuara shumë specifike në fushën e komunikimeve elektronike, për hir të së vërtetës, në tregun shqiptar numërohen me gishtat e dorës. Dua të them se janë të pakët. Tregu shqiptar është një treg i vogël dhe nuk ka ndonjë larmi të jashtëzakonshme ofruesish të shërbimeve për ato të mira apo për ato mirëmbajtje që na duhen neve. Ju jap vetëm një shembull: stacionet e shërbimit të monitorimit, që ne kemi në territorin shqiptar, nga njëra anë janë prej shumë vitesh në mirëmbajtjen e një shoqërie amerikane, nga njëra anë në mirëmbajtjen e një shoqërie gjermane. Nuk ka as ofrues shqiptarë në treg, në lidhje me këtë gjë. Procedura zhvillohet normalisht. Ai që vjen, vjen, paraqet çfarë paraqet dhe kualifikohet në bazë nga njësia e prokurimit, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse janë totalisht autonom dhe në çdo moment mund të bëhet një audit, një kontroll në AKEP, në lidhje me këtë gjë, dhe për ta nxjerrë në shesh vlerësohen sipas kriterëve specifike të veçanta a nuk e di se çfarë, për t'u përzgjedhur. Duhet të kuptoni diçka: AKEP-i posedon sisteme...

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, ju lutem!

Tomi Frashëri – Jo, të shpjegoj.

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja nuk ju vuri në diskutim cilësinë e prokurimit.

Tomi Frashëri – Dakord! Në rregull! Ndjesë!

Arben Pëllumbi – Pyetja ishte kjo: keni thënë se keni marrë ofertën më të ulët, kur është vetëm një. Vetëm kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkurt fare në lidhje me këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem tani, se e sqarova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lefter Gështenja – Në dhjetë procedura ju keni një operator. Çfarë do të bëni me këtë? Këtë më shpjego? Absolutisht që nuk e vë në dyshim mënyrën se si është bërë procedura ligjore. Të lutem! Kërkohet realizimi. Patjetër. Realizim buxheti. Patjetër. Nuk ka pasur garë, zotëri! Ju thoni se në këtë procedurë ka fituar oferta më e ulët, ndërkohë që ka vetëm një person. Ky është turp! Kjo është qesharake!

Tomi Frashëri – Në raport...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja, tani le të mos kalojmë në...

Tomi Frashëri – Vetë thatë se nuk paragjykoni institucionin, ndërsa tani thoni se është turp.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Ju keni të drejtë të pyesni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tomi Frashëri – ne jemi shumë seriozë, por edhe ju të jeni pak etik, se unë nuk kam ardhur për...

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja, le të mos kalojmë në përdorimin e fjalëve që nuk janë të denja për këtë komision. Sigurisht, zoti Frashëri është këtu për t'u përgjigjur. Në rast se është kështu siç thoni ju, ne e kuptojmë të gjithë se po qe një, nuk mund të themi dot se është oferta më e ulët, se s'ke me çfarë e krahason, por lejojeni të përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai nuk po i shmanget asnjë pyetjeje. Përkundrazi, po përgjigjet më gjerë se sa duhet, aq sa ne po i heqim vërejtje se po flet më shumë nga sa duhet. Pra, nuk po u shmanget përgjigjeve.

Ju prapë këtu jeni dhe mund të vazhdoni ta pyesni.

Zoti Frashëri, ju lutem, fjala për ju!

Tom Frashëri – Besoj se e dhashë përgjigjen time. Absolutisht, në çdo rast Kuvendi është në të drejtën e vet që të verifikojë një gjë që është thënë globalisht në raport. Nuk janë marrë as procedurat një nga një, sepse nuk është vendi në raport për këtë gjë. Ne kemi bërë një pasqyrë të tablosë së përgjithshme të performancës së institucionit dhe kaq. Kësisoj, në lidhje me secilën nga procedurat, patjetër që AKEP-i është çdo moment në dispozicion, qysh sot, që cilitdo anëtari të Kuvendit të Shqipërisë t'i paraqesë gjithçka që duhet, çdo lloj procedure, për të verifikuar dhe për të bërë vërejtjet e rastit.

Atëherë, për sa i përket rrezatimit, AKEP-i ka sqaruar disa herë që nuk ka kompetencë ligjore. Është një komision kombëtar që merret me matjen e rrezatimeve. Ajo që bëjmë ne si AKEP, është të japim një dorë, në kuadrin e një bashkëpunim ndërinstitucional, meqenëse kemi disa pajisje të caktuara për matjen e emetimit të valëve, që të ndihmojmë komisionin. Madje, në shumë raste e kemi bërë këtë me kërkesën e qytetarëve. Këtë e bëjmë shpesh, sepse qytetarët bëjnë kërkesa që ne të shkojmë pranë shtëpive të tyre, pranë shkollave, kudo që ata shikojnë ose mendojnë se mund të ketë një shqetësim emetimi valësh elektromagnetike. Ne bëjmë matjet e duhura dhe nxjerrim raporte për këtë. Për hir të së vërtetës, deri më sot, raportet e AKEP që nuk janë detyruese për Komisionin e Rrezatimit, sepse ai është kompetent sa i takon kësaj çështjeje, ka verifikuar se normat e emetimit elektromagnetik janë më të ulëta se normat ndërkombëtare. Raportet mund t'i vëmë dispozicion. I kemi të publikuara edhe në uebsajt.

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, ju e dini se pothuajse vit për vit, kur kemi marrë në shqyrtim raportin tuaj, ne e kemi ngritur këtë çështje. Kjo sepse është mirë ta përsërisim për ata që na dëgjojnë, por edhe për shqetësimin qytetar, që në të gjitha rastet kur ju keni bërë matje vit për vit atje ku ju është kërkuar të bëni matje, ka rezultuar se niveli i rrezatimit është brenda normave të lejuara. Mua më vjen mirë që zoti Gështenja e bëri këtë pyetje, se përndryshe do ta kisha bërë unë, pasi duhet ta ritheksojmë vazhdimisht kur ju kemi përballë, që në rastet kur ju keni bërë një monitorim të tillë ka rezultuar se rrezatimi është nën normat e lejuara. Kësisoj, ky shqetësim i qytetarëve, mbase shqetësim i drejtë, por mbase edhe nga padija, të adresohet për të kuptuar se nuk kemi realisht shqetësime në atë aspekt. Mund të vazhdoni me pyetjet e tjera.

Tom Frashëri – Atëherë, për sa i përket brezit 800. Siç dihet, në pjesën më të madhe brezi 800 i është alokuar dy kompanive të telefonisë celulare. Ka mbetur një lot i paalokuar, për arsye se kur u bë ndarja, në momentin që do të bëhej ankandi, u bë për tre operatorë. Një nga këta operatorë, për arsye të problemeve të mëdha në likuiditet nuk e mori pjesën që i destinohej

për brezin 800. Pjesa e mbetur e brezit 800 e ka shtyrë AKEP-in që, edhe në bazë të rezolutës së Kuvendit, të bëjë një konsulencë ndërkombëtare për punën e mirëshfrytëzimit të atij spektri, por sigurisht edhe për të parë se sa relevant është ai spektër në vetvete. Duke qenë se çdo vit kalojmë në teknologji të brezit të ri, sidomos 5G dhe më tutje, për aq pjesë sa ka mbetur brezi 800 mund të humbasë deridiku vlerën e tij. Ne kemi parë të gjitha mundësitë me kombinimet e pjesëve të tjera të spektrit, në mënyrë që të fuqizohet shfrytëzimi eficient. Kemi dalë në disa konkluzione dhe rekomandime, të cilat sigurisht ia rezervojmë një faze të dytë, kur të ketë interes. Sepse, çfarë ndodh? Normalisht, një brez jepet nëpërmjet disa procedurave të caktuara, përfshirë edhe ankandin, në bashkëpunim mes AKEP-it dhe qeverisë shqiptare në momentin që ka një interes për këtë, në momentin që unë dua të marr një pjesë të spektrit. Nëse nuk marr një pjesë të spektrit, nuk mund ta marr me zor dhe as nuk mund të hapen procedura ankandi, sepse thjesht do të rezultojnë dështake. Konsulenca është dhe në momentin që do të ketë, e ndoshta mund të ketë, ne jemi të hapur. Operatorët janë në dijeni. Praktikisht, kemi punuar edhe me operatorët për të marrë mendimet e tyre. Ata janë në dijeni të kësaj mundësie. Të gjitha opsionet janë në tryezë në momentin kur është një operator, dy operatorë, sepse brezi mund të ndahet edhe një herë pesë; patjetër që ne do ta marrim në konsideratë dhe do të vijojmë edhe në bazë të rezultateve që kemi nga konsulencia. Pra, e kemi gati dispozitivin, në rast se do të kemi një shprehje interesi.

Pyetja që ka të bëjë me Autoritetin e Konkurrencës. Në fakt Autoriteti i Konkurrencës është një nga autoritetet, me të cilin kemi kontakte më të shpeshta, kjo edhe për diçka sistematike, pasi çdo tre muaj ne raportojmë në AKEP çmimet e ofertave, që i propozohen konsumatorit nga ana e operatorëve, për arsye se tregu i pakicës është pa diskutim nën mbikëqyrjen e AKEP-it, por kryesisht është nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Konkurrencës, duke qenë se është një treg i parregulluar. Me Autoritetin e Konkurrencës kemi komunikuar në lidhje me çështjen e çmimit të ofertave, kemi komunikuar kur u bë një mërxh në tregun shqiptar, që ishte ai i telefonisë fikse midis Vodafonit dhe ABCOM-it. kemi komunikuar edhe gjatë këtij procesi, që u përmend këtu kryesisht nga deputeti Bushati, në lidhje me transaksionin e ndodhur në strukturat aksionare të dy kompanive. Pra, jemi gjithmonë në komunikim të vazhdueshëm me Autoritetin e Konkurrencës, që siç e thashë edhe një herë, është autoriteti me të cilin kemi kontaktet më të shpeshta. Nëse kërkohet diçka më specifike mund të përgjigjem.

Arben Pëllumbi – Zoti Nasufi! Më pas zoti Mziu.

Fadil Nasufi – Mua më duket sikur po zgjatemi pak me interpretimet shumë analitike që po bën zoti Frashëri. Edhe vetë raporti është shumë i hollësishëm. Është një raport proaktiv dhe ka një formatim sipas ligjit përkatës, me të cilin AKEP-i funksionon. Ndërkohë edhe revolucioni digjital dhe gjithë bota e internetit ka një zhvillim progresiv, të cilit edhe AKEP i është përgjigjur, duke pasur parasysh edhe situatat që kemi kaluar, kur ka qenë edhe shumë afër problemeve që krijoi pandemia.

Tani le të dalim te ca gjëra praktike, që janë në perceptimin e publikut, si për shembull rasti kur u fol për largimin e antenave që kanë rrezatim, gjë që më shumë ka karakter psikologjik se sa është diçka e monitoruar, që të jetë edhe si imazh, por edhe si garanci e mosndikimit të tyre, apo ofertat që jepen për periudha të caktuara, që kur jepen në fillim e kanë të maksimizuar kohën, ndërsa më pas fluturojnë ato sekondat e shpenzimit të impulseve.

Një problem tjetër që lidhet me praktikën prezente, ka të bëjë me kabllo të televizorëve kabllore, gjë që e kam ngritur këtë edhe te Komisioni i Medies. Marr si shembull zonën historike të Beratit. Lypset një bashkëpunim me qeverisjen vendore, që imazhi i tyre dhe gjithë prezenca që krijon problematikë duhet të ketë një bashkëpunim, që të kenë edhe një fund. Të mos jenë kablo ajrorë apo të jenë me atë prezencë që kanë sot. Apo problemet e shtrirjes së linjave të internetit në akset e rrugëve, thjesht për mungesë rakordimi. Të paktën ashtu siç jemi mësuar ne, se jemi disa ish-kryetarë bashkish këtu. Siç marrim leje për ndërtimet, nga Elektriku, nga Zjarrfikësi, nga Mjedisi, ndoshta duhet që edhe në objektet e reja të futet shtrirja e kabllove të rrjetit të internetit, që të mos jetë me rikthim mbrapsht, që të bëhet sërish një ngacmim i infrastrukturës.

Ndërkohë, në lidhje me problemet që ndeshim me komunitetin, po jap një rast praktik. Kemi shërbimet online, dhe kemi arritur sot në 1212 shërbime online. Mirëpo këto duan që të jetë i maksimizuar mbulimi me digjitalizim. Nganjëherë nuk dihet kujt i ngelet përgjegjësia. Po them një rast konkret. Ishin këto aplikimet në lidhje me faktin se kush është i pari në shpejtësi, për të fituar grante nga AZHBR-ja. Nga pafuqia e internetit në një zonë që është periferike, pavarësisht se ai e ka numrin e krerëve atje, nuk zë dot radhën në momentin e aplikimit, për shkak të internetit apo për shkak të fikjes së dritave, e kësaj të gjithë fituesit në blegtori dalin në zonën e Vlorës, për shembull. Kush e mban përgjegjësinë? Nuk është mirëfilli e lidhur me ju kjo punë, por ka një qasje edhe me pyetjen që bëri zoti Gështenja. Pra, ne duhet të jemi në një bashkërendim të të gjitha institucioneve, që konsumatori, i cili është ai që i ndjen kostot, kur ka

ndëshkim apo penalizim nga këto cedime që ndodhin, ndaj të gjithë jemi të investuar që të kemi edhe një rakordim ndërinstitucional sipas kompetencave dhe hapësirave që ligji i jep gjithësecilit.

Kësisoj, unë e vlerësoj raportin në përgjithësi, por ca gjëra praktike dhe ca bashkëpunime ndërinstitucionale duket se janë prezente dhe kërkojnë një reflektim më të mirë në gjithë dinamikën e përditshme, sepse shërbimet digjitale dhe interneti janë jetike dhe pothuajse dominante në përditshmërinë tonë. Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Në fakt, tashmë kjo çështja e kablllove nëpër qytetet tona, është një çështje që e kemi ngritur prej vitesh dhe sigurisht AKEP-i ka bërë detyrën e tij. Ishte në rekomandimet e vitit të kaluar, do të jetë edhe në raportin e vitit që vjen, sepse vazhdon të ngelet. Pavarësisht përpjekjeve maksimale që mund të bëjë AKEP-i, nuk mund të bëhet pa një bashkëpunim me administratën lokale. Në fakt, ne vëmë re se atje ku administrata lokale është më disponibël dhe më e angazhuar, kanë filluar të largohen dhe të zhduken nga syri i njerëzve, sidomos në zona të caktuara. Megjithatë, ky vazhdon të ngelet akoma një problem, të cilin edhe në rekomandimin për vitin që vjen do të vazhdojmë t’juaj lëmë si detyrë. Vërtet na duhet shtrirja, na duhet të mbërrijë broadband-i, na duhet cilësia e shërbimit, por jo në kurriz të atij trafiku ajror kabllosh, i cili të krijon pamjen e shëmtuar të një qyteti, që mjaft e ka kaosin nëpër rrugë, që ta ketë edhe në ajër.

Zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë nga kolegët ngritën ca problematika, që sot ekzistojnë, ndërsa unë dua të theksoj një nga problemet që ngelet shqetësues për konsumatorin shqiptar, që është monopolizimi. Rrjetet celulare, që në fillimet e tyre ishin me katër operatorë, por ishte edhe rrjeti fiks, sot janë konvertuar në dy operatorë, madje operatorë që i kanë të dyja shërbimet, edhe atë të celularit, edhe atë të rrjetit fiks. Kjo do të thotë se janë krijuar problematika serioze te konsumatori, për shkak të mungesës së konkurrencës, ndaj mbetet e frikshme edhe perspektiva e saj. Duke parë thjesht monopolizimin, po i referohem qarkut të Dibrës: kur unë shkoja më përpara në disa nga fshatrat, nuk merrte AMC-ja, merrte Vodafoni, merrte Eagle, ndonjë kompani tjetër. Tani së fundmi, kur ishim në fushatë, nuk merrte celulari, sepse kanë ngelur vetëm dy kompani. Besoj se roli kryesor i AKEP-it, i qeverisë në fakt, meqë ju jeni përfaqësuesi konkret, do të jetë për t’i

dhënë mundësinë çdo konsumatori, që të ketë të drejtën e këtij shërbimi. Në fakt, kjo gjë nuk ka ndodhur, ndaj po shkohet në regres. Për shumë arsye, kjo ka një efekt negativ të jashtëzakonshëm.

Së pari, po marr rastin e pandemisë, kur studentët shkonin nëpër shtëpi dhe e kishin të pamundur të merrnin mësim online në zonat ku ata banonin.

Së dyti, po ta shohësh sot, shërbimi është kaluar te e-Albania. Si mund ta marrë shërbimin dikush në këtë qark, po themi, pa iu referuar të tjerëve, kur ai nuk ka internet, ku ai s'ka asnjë lloj mundësie për ta marrë këtë shërbim, e për pasojë do të jetë i detyruar të ecë me kilometra të tëra për të shkuar tek zyra?

Pra, çfarë dua të them? Efekti monopolizues është në dëm të konsumatorëve. Veç kësaj nuk është social. Kjo ndikon në shpopullimin e zonave. Nuk ka se si të rrijë, po themi, një qytetar apo një fshatar në ato zona, kur i mungon komunikimi, i mungon shkolla dhe shumë standarde të tjera. Një tjetër problem shqetësues, pavarësisht se u tha edhe nga kolegët, e dhënë si detyrë që në vitin 2020, është ajo merimanga e këtyre operatorëve të vegjël të shpërndarjes së internetit. Madje nuk mjaftohen vetëm me ato tela pa fund, por në një metër katror, buzë trotuarit, mund të shohësh pesë, dhjetë shtylla. Nuk përdorin vetëm një shtyllë, të paktën, sa për të vendosur ca tela, por secili do një shtyllë dhe një tel. Pra, kjo do të thotë se ju duhet të keni një rol në këtë drejtim, kjo jo vetëm për të ushtruar autoritetin tuaj, por dhe për të qenë një zë edhe tek aktorët e tjerë, te pushteti qendror dhe ai lokal, me qëllim heqjen e këtij rrjetëzimi e si rrjedhojë për të krijuar një tjetër standard, një tjetër qasje.

U tha se gjatë vitit 2021 ka pasur progres, që do të thotë se ka pasur progres edhe në aspektin ekonomik të këtyre kompanive. Megjithatë, ne nuk shohim një produkt në uljen e tarifës, në rritjen e cilësisë së shërbimit apo qoftë dhe në emetimin e atyre paketave që jepeshin në kohën e pandemisë, që sot janë të rëndësishme. Kjo do të thotë se, nëse së paku ato nuk e kanë konvertuar, si autoritet për të përcaktuar koston dhe tarifën, si autoritet që mund të ngrini zërin, ju patjetër që duhet të ndikoni te këta operatorë në lidhje me uljen e tarifave e për hapjen e këtij shërbimi, me synim deri afrimin e konsumatorit të fundit në Shqipëri.

Ka edhe mjaft gjëra të tjera, të cilat mund t'i thosha, por meqenëse shumë nga kolegët i përmendëm, nuk po zgjatëm më. Megjithatë, edhe një herë do të kërkoja që të kemi vëmendjen e duhur për të kapur zonat e thella. Madje jo vetëm zonat e thella, por edhe qarqet e largëta, gjithnjë duke e parë edhe në aspektin social.

Po të shohësh shkollat sot, është absurde që në vitin 2022 të ketë shkollë pa internet, është kriminale. Kjo nuk është vetëm kompetencë e juaja, por mbaj mend se para afro dhjetë vjetësh a më shumë, Posta Shqiptare ka pasur një iniciativë në bashkëpunim me bashkitë, për të vendosur paketa interneti nëpër këto shkolla. A nuk do të ishte normale që të ushtronit autoritetin tuaj te këta operatorë, për të pasur paketa në gjithë sistemin arsimor, edhe në atë shëndetësor, edhe në atë të shërbimeve ndaj qytetarëve, pra për të pasur nukle të caktuara, për t'u ardhur në ndihmë këtyre qytetarëve?

Këto ishin disa nga gjërat që kisha për të thënë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Zoti Frashëri, ju lutem, pjesa më e madhe e gjërave që ngriti edhe zoti Mziu janë çështje që i diskutuam. Kësisoj, do t'ju lutesha të na bënit një përmbledhje të shkurtër, për të bërë mbylljen, në lidhje me disa nga temat që ngritëm edhe ne të tjerët, si për këtë paketën pesëmijëlekëshe, si për kabllot. Po ashtu edhe për këtë aspektin social. Ne sot kemi një shërbim të e-Albania, i cili sigurisht i mbylli sportelet, por ndokujt në ndonjë zonë të largët, do t'i duhet që për ta marrë atë shërbim të përshkojë njëfarë rruge. Në fakt, ai e ka bërë edhe përpara këtë, pasi shërbimin nuk e kishte te shtëpia, por sado që të jetë, meqenëse bota po bëhet shumë digjitale, po bëhet shumë elektronike, çfarë mundësish ekzistojnë? Ju e thatë planin për zonat e bardha, për mbulimet e të tjera, por do të donim një përmbledhje për ta përmbyllur tërë këtë.

Shkurt, ju lutem!

Tom Frashëri – Si fillim, po bëj një sqarim: ndoshta është mirë t'i referohemi edhe raportit për vitin 2020, ku ka një pasqyrim shumë të detajuar të asaj çfarë është bërë gjatë pandemisë. Duhet kuptuar se gjatë pandemisë, konsumatorit shqiptar iu dha gati shtatë herë më shumë internet si në mobile ashtu edhe në fiks. Pra, totalisht përtej çmimeve. Kjo ishte një kërkesë e qeverisë shqiptare, një koordinim i rregullatorit, kështu që të gjithë operatorët e bënë këtë sforco. Pra, ajo që është dhënë gjatë pandemisë është diçka që tejkalon totalisht detyrimin që ka çdo operator, në bazë të kontratës. E gjithë kjo u bë për qytetarët. I keni të gjitha shifrat në raportin e vitit 2020, ku del në pah se çfarë përpjekjeje e jashtëzakonshme është bërë, me qëllim që shqiptarët të vazhdonin të ishin të ndërlidhur. Paketa pesëmijëlekëshe, si të gjitha paketat e tjera, kishte më shumë internet pikërisht për këtë arsye. Në qoftë se paketa ka sot diçka më pak, nuk është ai problemi me çfarë thuhet dhe sa është. Ajo është tjetër gjë. Nëse ka më pak, kjo ndodh ngaqë jemi kthyer në një normalitet të caktuar, sepse nuk mund të vazhdohet pafundësisht

të jepet më tepër nga sa kontrata parashikon. Nuk duhet të harrojmë një gjë: me gjithë dëshirën tonë për mbrojtje sociale, për promovim të të drejtave të të gjithëve për akses, bëhet fjalë për sipërmarrës privatë, të cilët qëllim kryesor kanë fitimin, nga të cilët kërkohet investim maksimal në lidhje me infrastrukturën e rrjeteve në këtë vend. Pra, ata bëjnë edhe investimin, ata duhet të marrin mbrapsht edhe fitimin. E ripërsëris këtë gjë, sepse është me rëndësi. Në 2020-ën u bë një sforcë e jashtëzakonshme. Të gjithë ne kemi marrë më shumë internet, kemi folur më shumë në telefon, gjithnjë duke paguar më pak parë, pasi kjo ishte politika sociale, që qeveria kërkoi të implementohej nga operatorët. E përsëris: këtë e kemi në raportin e vitit 2020. Është shumë interesante për t'u parë.

Tani, sa i takon pjesës së *e-Albania* e të tjera me radhë, mund të ketë me raste njëfarë disharmonie midis shërbimeve në masë që ofrohen e që janë krejt normale t'u ofrohen qytetarëve, por dhe përparimit të fuqisë së rrjeteve në vetvete. Kjo nuk ndodh vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, për aq kohë sa shërbimet e digjitalizuara avancojnë më shumë se sa vetë digjitalizimi si rrjet, si kapacitet. Patjetër që AKEP-i është në kontakt me operatorët në lidhje me çështjet e shtrirjes e të mbulimit, por pastaj ne nuk kemi kompetenca sa i takon çështjes se si funksionon *e-Albania* në zona të caktuara të vendit. Çfarë bëjmë ne? Nëse na vijnë ankesa, sepse edhe ne duhet të kemi faktin, nuk jemi shërbim policor për internetin e për rrjetet, arsye për të cilën është e domosdoshme që fakti të na notifikohet.

Zoti Mziu, në mos gaboj, përmendi një problem në Dibër, a nuk e di se çfarë. Duhet të na thuhet, me qëllim që ne të vijmë të bëjmë matjet e të tjera me radhë.

Edhe një gjë tjetër, që dua të them këtu. Vitin e kaluar u ndërtua një sistem i tërë për matjen e cilësisë së shërbimit, që e kemi në faqen tonë të internetit. Shkoni dhe matni cilësinë e shërbimit. Matni cilësinë e shërbimit nëse është reale apo jo, dhe nëse nuk është reale, e jani tek ne, që të merren masa si për respektimin e kontratës mes pajtimtarit dhe ofruesit të shërbimit, ashtu dhe detyrimet e ofruesit të shërbimit. Ne gjuajmë në saje të fakteve, të cilat i analizojmë. Sepse raportimet, si kudo në botë te rregullatori, për shifra e për statistika, vijnë nga vetë operatorët. Më pas, ne bëjmë mbikëqyrjen tonë *ex post*, shikojmë nëse janë të sakta apo jo, për sa kohë që na referohen probleme.

Në lidhje me çështjen e kabllave, zoti Nasufi e di shumë mirë edhe nga përvoja e tij me pushtetin lokal, e tha edhe këtu, gjë për të cilën e falënderoj, ajo është një nga dy pikat që janë pikat në proces realizimi në rezolutë. Ka një larmi aktorësh atje. Pra, AKEP-i është rregullator

dhe duhet të sigurojë të gjitha kompanitë, për hir të konkurrencës, që të kenë mundësi të shkojnë te klientët, që edhe klientët të kenë mundësi të zgjedhin kompaninë që dëshirojnë. Problemi i kabllave, përveç se është i trashëguar, është një problem që ka të bëjë me çështje të zhvillimit infrastrukturor brenda qyteteve, që ka të bëjë me miradministrimin e administratorëve të pallateve, në lidhje me çështjen e të drejtës së kalimit.

Këto nuk janë të verifikueshme e të kontrollueshme nga AKEP-i, sepse janë kompetenca të tjera. Ne shohim që të gjitha kompanitë të kenë mundësi të kenë akses te një klient, e më pas klienti të mund të përzgjedhë kompaninë që dëshiron. Ka të bëjë me bashkëpërdorimin e infrastrukturës së shtyllave, të rrjeteve ajrore me posedues të kësaj infrastrukture, siç janë OSHEE-ja e të tjera me radhë. Pra, ka një sërë problematikash, të cilat ne mundohemi t'i adresojmë çdo vit. Nëse nuk e themi "të perealizuar", nuk është për të thënë se ka edhe gjëra që nuk i realizojmë. Vitin e parë kemi pasur të perealizuara. Po themi se është gjithmonë një proces. Pra, ne kemi shkëmbime me bashkitë, kemi shkëmbime me OSHEE-në, kemi bërë dhe mbledhje, janë gjëra që duan kohë për t'u zgjidhur. Është një çështje e trashëguar.

E mos harroni, siç e përmendët edhe ju, zoti kryetar, që në fund të ditës të gjithë duam të jemi të ndërlidhur, pra duam shërbimin, ai që pramon është shërbimi. Pra, nuk është të gjej infrastrukturën, se si ta shtrij rrjetin, qoftë ajror, qoftë nëntokësor, por është se dua lidhjen dhe e dua tani, sepse kam nevojë për internet.

Ka edhe një gjë këtu: sa herë që na kërkohet nga përdoruesit, qofshin këta nëpër pallate, qofshin nëpër lagje, qofshin kudo, AKEP-i ndërhyr në çdo rast që kërkohet, në mënyrë që t'i detyrojmë operatorët, aq sa mund t'i detyrojmë, të fusin kabllot nëpër kanalina, të heqin kabllot që janë inaktive e të tjera me radhë. Është një punë, që ne do ta bënim, do të angazhoheshim me shumë dëshirë në fushatë, nëse dhe nga ana e pushtetit lokal, i cili ka shumë halle, do të kishim një fokusim më të madh te kjo pjesë. Jemi të gatshëm për këtë gjë. Teknikët i kemi, mundësinë për ta bërë e kemi, por na duhet autoriteti lokal, mbi të gjitha, i cili ka kompetencat për të ndërhyrë, për të marrë masa e për të sistemuar çështjen e kabllave. Sigurisht, peizazhi urban na dhemb, na dhembin antenat e shumta, që ju e thatë se kanë efekt psikologjik, por me zhvillimin e teknologjisë, duke kaluar dora-dorës edhe te 5 G-ja, ato do të fillojmë të rrallohen. Kjo është. Sa më shumë të zhvillohet kapaciteti i rrjetit dhe i teknologjisë që mbështet rrjetin, aq më pak antena do të ketë, sepse ato do të vinë duke u minimizuar apo do të jenë më të padukshme.

Megjithatë, ky është një tjetër stad. Nuk jemi ende aty. Të gjitha këto i mbajmë shënim dhe përpiqemi të bëjmë atë që kemi mundësi të bëjmë si rregullator.

Arben Pëllumbi – Zoti Frashëri, ju falënderoj për të gjitha shpjegimet që dhatë!

Po, zoti Bushati!

Ju lutem, shkurt!

Helidon Bushati – Zoti Frashëri, marr shkas nga ndërhyrja e fundit, si efekt informimi për veten po edhe për publikun. Në raport thuhet qartësisht se ju keni bërë hapat proceduralë, pararendës për ankandin më të madh që do të ndodhë e që do të sjellë futjen e 5G-së në Shqipëri. Kur mendon AKEP-i, se do të lançohet ankandi i 5G-së?

Një opinion, jo në cilësinë e orakullit, por si një parashikim i përafërt: sa mund të arkëtohet nga ankandi i 5G-së?

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, thatë se do të bënit një pyetje të vogël, por hapët një temë kaq të gjerë tashti, sa që zoti Frashëri do të na mbajë dy orë këtu. Shpresova shumë që të mos hynim te 5G-ja, por ju lutem, zoti Frashëri, shumë shkurt.

Tom Frashëri – Mua më vjen mirë që veprimtaria e AKEP-it nxit këtë ndërveprim mes nesh. Atëherë, shumë shkurt: normalisht, brezi i spektrit që do të duhet të bëhet objekt ankandi, është brezi 700 megaherc, i cili është ende nën administrimin e rregullatorit të medieve audiovizive. Në parim, nëse gjithçka shkon mirë, në fund të muajit qershor do të kalojë nën administrimin e AKEP-it. Nga ai moment, gjithë faza e ankandit, praktikisht me të gjithë hapat e vet, zgjat rreth gjashtë muaj. Tani çfarë ndodh? Marrja në administrim është një gjë që do të ndodhë në fund të qershorit, në qoftë se ne fillojmë diskutimet me operatorët. Çështja është shumë e thjeshtë: që të bëhet ankandi, duhet të duan ta blejnë. Që të duan ta blejnë, sigurisht që duan ta blejnë, por duhet të kenë kapacitete. Pra, duhet të kenë parashikueshmërinë financiare për atë gjë. Prandaj nuk kemi avancuar shumë, sepse ka qenë gjithmonë çështja e shtatëqindëshit. Tani që shtatëqindëshi lirohet, çlirohen të gjitha energjitë pozitive, që të mund të ulemi e të flasim. Ka disa opsione ankandesh. Nuk mund t'i rreshtoj këtu, sepse është diçka e komplikuar. Gjëja kryesore që do pasur parasysh, është se duhet të kemi në mendje maksimizimin e çmimit apo duhet të kemi në mendje optimizimin e shërbimeve dhe detyrimeve, që operatorët do të marrim përsipër. Pra, duhet parë balanca e mirë. Gjatë konsulencës kemi marrë shumë ide interesante edhe nga Shtetet e Bashkuara, edhe nga Bashkimi Europian. Do të vazhdojmë të shohim, pasi është hera e parë që do të ndodhë kjo. Ka shumë e shumë mënyra, ka shumë e

shumë formula. Ne do të shikojmë formulën që është më e përshtatshme për ne, pa diskutim. Këtë e them si AKEP, se pastaj është çështje vendimmarrjeje në instanca të tjera. Sigurisht, ne si AKEP-i na intereson, sa u takon detyrimeve që kemi për të mbikëqyrur mbulimin e mirë e të tjera me radhë, që të ketë detyrime sa më të forta për operatorët që do të marrin këtë brez shumë të gjerë, me aplikime të shumëfishta, për të pasur mbulim për konsumatorin.

Nuk them dot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet parë nëse është teknikisht e mundur për operatorët. Për ne është e mundur ta fillojmë këtë vit. Procedurat e ankandit e kemi të mundur t'i fillojmë, se zgjasin rreth gjashtë muaj. Ne mund t'i fillojmë që në shtator. E kemi në dorë këtë. Çështja është nëse operatorët janë gati të futen në këtë lojë. Kjo është çështja.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Frashëri!

Faleminderit të gjithë stafit tuaj, që ishte i pranishëm këtu, për punën e bërë, për raportin që na është paraqitur. Ne do të mblidhemi në një seancë tjetër për të bërë rezolutën, të cilën pastaj do t'ia paraqesim seancës plenare për miratim, ndërkohë që ju do të vini për raportim para seancës.

Ju faleminderit, kolegë!

Mbledhja mbyllet këtu!

MBYLLET MBLEDHJA